# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5562
E mërkurë, 29 gusht 2018
çmimi 0.40 €

## Rashit Qalaj emërohet drejtor i Policisë së Kosovës FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de



FLET PËR "EPOKËN E RE", VIGAN QORROLLI FAQE 4-5

# LIBE pritet të ketë raport pozitiv për liberalizimin e vizave

Njohësi i integrimeve evropiane, Vigan Qorrolli, është shprehur i bindur se edhe Komiteti për Liritë Civile, Drejtësi dhe Çështje të Brendshme (LIBE) i Parlamentit Evropian, që do të mblidhet sot (e mërkurë), do të votojë pro liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se në procesin e vendimmarrjes së BE-së për këtë çështje do të ngrihet edhe çështja e ish-prokurorit special Elez Blakaj. Sipas tij, në këtë proces do të ketë shtete që do të diskutojnë për dilemat rreth ndërhyrjes së politikës në drejtësi. Ai ka bërë me dije se BE-ja do t'i liberalizojë vizat jo më herët se në pranverën e vitit 2019. Në këtë intervistë Qorrolli ka dhënë kritika për sistemin e drejtësisë që, sipas tij, nuk po punohet sa duhet për luftimin e krimit dhe korrupsionit

## Qeveria ndan 815 mijë euro për pastrimin e Kosovës FAQE 3



Aksioni për pastrimin e Republikës së Kosovës, i cili do të fillojë më 15 shtator dhe pritet të përfundojë më 15 dhjetor, do t'i kushtojë buxhetit të shtetit 815 mijë euro. Kjo është bërë me dije në mbledhjen e së martës të kabinetit qeveritar, ku edhe është marrë vendimi për ndarjen e këtyre mjeteve për realizimin e aktiviteteve në kuadër të aksionit "Ta pastrojmë Kosovën". Qeveria ka marrë vendim për ta ndihmuar Komunën e Preshevës me mjete në vlerë prej 112 mijë eurosh me të cilat parashihet ndërtimi i "Parkut të paqes" dhe një kënd i lojërave për fëmijë



## Ministri Bytyqi thotë se nuk ka pasur parregullsi në testin e maturës

## AKTUALE



Ylber ÇITAKU

PARTITË POLITIKE VAZHDOJNË TË UDHËHIQEN NGA PARIMI I INTERESAVE TË NGUSHTA PARTIAKE F. 6

MË 4 SHTATOR MBAHET SEANCA E JASHTËZAKONSHME PËR DIALOGUN F. 6

HARADINAJ: FSK-JA ËSHTË E GATSHME PËR TRANZICION F. 8

## EKONOMI

MMPH-ja NXJERR UDHËZIM ADMINISTRATIV PËR MENAXHIMIN E RESURSEVE UJORE F. 9

RRITET FONDI PËR MBËSHTETJE TË PROJEKTEVE TË KOMUNITETEVE JOSHUMICË F. 8

## KULTURË

'MY SHORT WORDS' FITON ÇMIMIN E PARË NË 'HYJNESHA NË FRON' 2018 F.13

## SPORT

THAQI: FLAMURTARI DO TË JETË BEFASIA E KAMPIONATIT F. 18

PANUCCI: GREZDA BËN 'SPEKTAKËL' NË FUSHË F. 18

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Janjiqi: Qëndrimi i ShBA-së për Kosovën do të kuptohet në takimin Trump - Putin



BEOGRAD, 28 GUSHT - Themeluesi i Forumit për Marrëdhënie Ndëretnike në Serbi, Dushan Janjiq, thotë se ShBA-ja nuk ka ndryshuar qëndrim për Kosovën dhe Serbinë. Ai thotë se Merkeli dhe Trumpi mund të mos kenë biseduar fare për çështjen e Republikës së Kosovës. Sipas tij, ky është vetëm një supozim dhe mashtrim i publikut. "Absolutisht është vetëm një supozim se ata kanë biseduar për Ballkanin Perëndimor dhe Kosovën. Ky është një abuzim me publikun gjoja se Amerika ka ndryshuar qëndrim sa i përket çështjes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë", është shprehur Janjiq për agjencinë e lajmeve BETA. Sipas tij, vetëm në një takim të ardhshëm ndërmjet Donald Trumpit dhe Vladimir Putinit, do të merret vesh nëse vërtet ShBA-ja ka ndryshuar qëndrim sa i përket zgjidhjes së çështjes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ai tha se ShBA-ja e sheh nga një perspektivë krejt ndryshe çështjen e Kosovës dhe problemin në Ballkanin Perëndimor për shkak të zhvillimeve në Lindjen e Mesme, por edhe për shkak të marrëdhënieve me BE-në dhe Rusinë. "Në Evropë, por edhe në Serbi, ishte krijuar një atmosferë totalitare, se vetëm një njeri duhej të ulej përballë një tjetri dhe të bënte marrëveshje pa palën e tretë. Tani më nuk është ashtu" ka thënë Janjiqi.

# Merkeli: Ndryshimi i kufijve Kosovë - Serbi mund të ketë pasoja për Ballkanin

Kancelarja gjermane Angela Merkel tha se marrëveshja e mundshme në mes të Kosovës dhe Serbisë, për ndryshimin e kufijve të tyre, mund të krijojë precedent dhe mund të çojë në negociata të ngjashme në vendet e tjera të Ballkanit



BERLIN, 28 GUSHT - Kancelarja gjermane Angela Merkel paralajmëroi se marrëveshja e mundshme në mes të Kosovës dhe Serbisë për modifikimin e kufirit të tyre të përbashkët mund të ketë pasoja në rajonet e tjera të Ballkanit. Merkel i bëri këto komente gjatë një konference për media në Berlin së bashku me kryeministrin e Kroacisë, Andrej Plenkoviq. "Ne natyrisht se i mbështesim të gjitha bisedat, që mund të çojnë drejt qëllimit, në të njëjtën kohë themi se integriteti territorial, ashtu siç është tani, është një vlerë e rëndësishme", tha Merkeli. Ajo paralajmëroi se marrëveshja në mes të Serbisë dhe Kosovës për territorin e tyre kufitar mund të krijojë precedent dhe mund të çojë në negociata të ngjashme në vendet e tjera të Ballkanit. "Duhet të jemi të kujdesshëm që negociatat në një vend të mos çojnë në negociata në një vend tjetër", u shpreh Merkeli.

Plenkoviq në anën tjetër tha se duhet të respektohen kufijtë dhe se çdo ndryshim territorial mund të ndikojë në pjesët e tjera të Ballkanit dhe të çojë drejt jostabilitetit.

Kancelarja Merkel kishte biseduar të hënën me telefon me presidentin amerikan Donald Trump lidhur me këtë çështje. Ajo tha të martën se "i mbështesim përpjekjet për një zgjidhje të përbashkët ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, por e cila ka parasysh tërësinë tokësore". Aktualisht janë shtuar debatet rreth normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që përfshijnë idetë për ndarje tokësore të Kosovës, shkëmbim territoresh e korrigjim kufijsh dhe dallimeve në qëndrimet amerikane e gjermane rreth kësaj çështjeje.

Të premten këshilltari për siguri kombëtare i presidentit amerikan Donald Trump, John Bolton, tha se Shtetet e Bashkuara nuk do të përfshihen në idenë për shkëmbimin e territoreve, por nëse palët merren vesh, nuk do të qëndrojnë në rrugë.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe homologu i tij serb, Aleksandar Vuçiq, kanë shpalosur së fundmi idenë për korrigjim të kufijve.

Presidenti Thaçi ka thënë të martën përmes një postimi në "Facebook" se përkrah bashkëngjitjen e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës si pjesë të territorit të Kosovës, mirëpo është kundër ndarjes apo shkëmbimit të territoreve.

Thaçi e Vuçiqi do të takohen më 7 shtator në Bruksel, në kuadër të dialogut mes dy shteteve që ndërmjetësohet nga shefja e diplomacisë evropiane, Federica Mogherini.

# Austria mbështet reformat në Shqipëri



TIRANË, 28 GUSHT - Ministrja shqiptare e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, është takuar me homologun e vet austriak Josef Moser, në Alpbach të Austrisë. Në qendër të diskutimeve ishte forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit midis dy vendeve, ecuria e reformës në drejtësi, bashkëpunimi për forcimin e luftës kundër korrupsionit si dhe organizimi për herë të parë në Shqipëri i Forumit Ministror BE-Ballkani Perëndimor për çështjet e drejtësisë dhe punëve të brendshme në tetor 2018.

Ministri Moser vlerësoi nismat e Shqipërisë për reformimin e sistemit të drejtësisë dhe luftën kundër korrupsionit. Ai u shpreh që Austria do të jetë gjithmonë një partnere në krah të Shqipërisë për mbështetjen në zbatimin e reformave të ndërmarra nga Shqipëria. Si tregues i mbështetjes dhe vlerësimit që Austria i ka dhënë Shqipërisë u theksua përzgjedhja nga Austria të Shqipërisë si vendi për organizimin e Forumit Ministerial BE-Ballkani Perëndimor për çështjet e drejtësisë dhe sigurisë që do të organizohet në Tiranë në tetor 2018.

Moser shprehu mirënjohjen që për herë të parë kjo ngjarje do të organizohet në Shqipëri duke promovuar vlerat dhe arritjet e mëdha që ka bërë deri tani Shqipëria si një vend kandidat për t'u bërë pjesë e familjes së madhe evropiane.

Ndërsa ministrja Gjonaj e njoftoi homologun austriak me rezultatet e para që reforma në drejtësi ka dhënë deri më tani duke njohur të gjithë kontributin që kanë dhënë ekspertët austriakë në këtë proces si dhe mbështetjen politike të Komisionit Evropian.

## Kongresistët amerikanë ftojnë për dalje masive në referendum



SHKUP, 28 GUSHT - Kongresistët amerikanë japin mbështetje të fuqishme për referendumin e çështjes së emrit. Përfaqësuesi i Qeverisë amerikane Bill Flores tha se integrimi në NATO dhe referendumi janë një mundësi e mirë për popullin e Maqedonisë. Ai shfrytëzoi rastin t'u bëjë thirrje qytetarëve që në numër sa më të madh të dalin dhe të shprehin vullnetin e tyre më 30 shtator. "Ne besojmë se referendumi dhe integrimi në NATO janë një mundësi e mirë për popullin e Maqedonisë, andaj me të vërtetë shpresojmë që populli të dalë dhe të votojë në referendum", tha Bill Flores, kongresist i ShBA-së. Kongresistët të martën zhvilluan takime me përfaqësues të organizatave joqeveritare. Të njëjtit u ndanë shumë të kënaqur nga takimi, duke vlerësuar se shoqëria civile në Maqedoni është shumë aktive. "Ishte një takim i mirë. Shoqatat civile janë me të vërtetë aktive këtu në Maqedoni dhe ne jemi shumë të lumtur që është kështu. Sot biseduam për qasjen e tyre në aktivitetet që ndodhin", deklaroi kongresisti Gerry Connolly.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Është mbajtur mbledhja e radhës e Qeverisë së Republikës së Kosovës

# Qeveria ndan 815 mijë euro për pastrimin e Kosovës



Aksioni për pastrimin e Republikës së Kosovës, i cili do të fillojë më 15 shtator dhe pritet të përfundojë më 15 dhjetor, do t'i kushtojë buxhetit të shtetit 815 mijë euro. Kjo është bërë me dije në mbledhjen e së martës të kabinetit qeveritar, ku edhe është marrë vendimi për ndarjen e këtyre mjeteve për realizimin e aktiviteteve në kuadër të aksionit "Ta pastrojmë Kosovën". Qeveria ka marrë vendim për ta ndihmuar Komunën e Preshevës me mjete në vlerë prej 112 mijë eurosh me të cilat parashihet ndërtimi i "Parkut të paqes" dhe një kënd i lojërave për fëmijë

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 28 GUSHT - Kabineti qeveritar të martën ka ndarë 815 mijë eurove për realizimin e aktiviteteve të aksionit "Ta pastrojmë Kosovën". Aksioni për pastrimin e vendit do të fillojë më 15 shtator dhe pritet të përfundojë më 15 dhjetor. "Qeveria ka shqyrtuar planin e aktiviteteve dhe buxhetin e realizimit të aksionit 'Ta pastrojmë Kosovën'. Aktivitetet do të zgjasin nga 15 shtatori deri më 15 dhjetor. Për qëllim të realizimit dhe mbarëvajtjes së këtij aksioni Qeveria do të ndajë një buxhet prej 815 035 eurove", është thënë në komunikatën e qeverisë.

Po në këtë mbledhje është marrë vendim që edhe Komuna e Preshevës të ndihmohet me mjete financiare prej 112 mijë eurosh me të cilat parashihet ndërtimi i "Parkut të paqes" dhe një kënd i lojërave për fëmijë. "Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar vendimin për ndarjen e mjeteve për asistencë financiare në vlerë prej 112 mijë eurosh për Preshevën për ndërtimin e një këndi të lojërave për fëmijë dhe për 'Parkun e paqes'. Parku i dedikohet rekreacionit dhe argëtimit të të gjithë qytetarëve të kësaj komune dhe pritet të ndikojë pozitivisht në kohezionin social të komuniteteve në këtë komunë. Projekti do të bashkëfinancohet me GIZ-in gjerman", është theksuar më tutje në komunikatë.

Gjithashtu, kabineti qeveritar ka ndarë 30 mijë euro për mbulimin e shpenzimeve të ceremonisë shtetërore për vdekjen e veprimtarit të shquar të çështjes kombëtare, Adem Demaçi. Këto mjete do të ndahen nga kategoria e rezervave.

Me qëllim të mbulimit të shpenzimeve shëndetësore të Gegë Ardit Gashit nga Gjilani, kabineti qeveritar ka ndarë mjete financiare në vlerë prej 20 mijë e 580 eurosh.

Mbështetje financiare nga Qeveria e Kosovës ka marrë edhe alpinistja Arineta Mula që ka shënuar rezultate të respektueshme në aktivitetet sportive të alpinizmit në skenën ndërkombëtare. Asaj i janë ndarë 35 mijë euro.

Po në mbledhjen e së martës kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, i ka njoftuar anëtarët e kabinetit qeveritar për pjesëmarrjen në samitin joformal të kryeministrave të vendeve të Ballkanit Perëndimor të mbajtur në Durrës.

Kryeministri ka vlerësuar prezantimin e Kosovës në këtë takim dhe ka shprehur falënderimin për komisionarin Johannes Hahn për apostrofimin e faktit të pabarazisë së qytetarëve të Kosovës në lëvizjen e lirë.

Haradinaj ka theksuar se është pajtuar me kryeministrin shqiptar Edi Rama që takimi i radhës i dy qeverive të mbahet në muajin nëntor në Pejë.

Haradinaj i ka informuar vartësit e vet edhe me aksionin e trajtimit të qenve endacakë duke thënë se janë shënuar rezultate në trajtimin e këtyre qenve dhe niveli i sigurisë së njerëzve është rritur.

Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin për ratifikim të marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës për programin e mbështetjes për ujësjellës dhe kanalizim në zonat rurale, Faza e VI. Programi do të kontribuojë në krijimin e sistemeve të reja më të favorshme për zhvillimin e shërbimeve të ujit në zonat rurale të Kosovës.

Aprovimin e kabinetit qeveritar e kanë marrë edhe dy projektligjet për ratifikim të marrëveshjeve për sigurimet sociale në mes të Republikës së Kosovës dhe Konfederatës Zvicerane dhe me Mbretërinë e Belgjikës. Me këto marrëveshje qytetarët do të mund ta gëzojnë të drejtën e pensionit kontributpagues, pensioneve familjare dhe invalidore të punës. Sipas këtyre marrëveshjeve, qytetarëve kosovarë do t'u mundësohet që pas arritjes së moshës së pensionimit në këto dy vende, të kenë të drejtë që pensionet e përmendura t'i marrin në Kosovë. Gjithashtu, ata do të kenë të drejtën e bashkimit të periudhave të kontributeve pensionale.

Kabineti qeveritar ka miratuar edhe Projektligjin për ratifikim të "Traktatit që themelon komunitetin e transportit", i themeluar nga Bashkimi Evropian dhe shtetet e Evropës Juglindore.

Në mbledhjen e së martës Qeveria ka miratuar edhe vendimin përfundimtar për shpronësimin për interes publik të pronave të paluajtshme që preken nga realizimi i projektit për ndërtimin e "Qendrës së komunitetit" dhe ndërtimin e "Shtëpisë së kulturës" në Restelicë të Dragashit.

Është miratuar edhe vendimi përfundimtar për shpronësimin e pronave të paluajtshme të ish-Ndërmarrjes Shoqërore "Gërmia" në Prishtinë për qëllim të akomodimit të institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar vendimin me të cilin i rekomandohet presidentit të Republikës së Kosovës që ta autorizojë Ministrin e Financave për nënshkrim të marrëveshjes së kredisë në mes të Republikës së Kosovës dhe "Unicredit Bank Austria AG" për financim të projektit të trajtimit të ujërave të zeza në Komunën e Podujevës.

Kabineti qeveritar ka miratuar edhe nismën për negocimin e marrëveshjes ndërkombëtare të kredisë në mes të Republikës ë Kosovës dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite për financimin e "Projektit të Qendrës Mjekësore Universitare" në Prishtinë.

Edhe nisma për negocim të marrëveshjes për kredi për financim të projektit "Ndërtimi i kanalizimit në Komunën e Shtimes" me "Unicredit Bank Austria AG" është miratuar.

## Rashit Qalaj emërohet drejtor i Policisë së Kosovës



PRISHTINË, 28 GUSHT (ER) - Qeveria e Kosovës me shumicë votash të martën ka emëruar Rashit Qalajn drejtor të përgjithshëm të Policisë së Kosovës. Emërimi i tij ka ardhur pas kalimit të ish-drejtorit të Policisë, Shpend Maxhuni, drejtor në Agjencinë e Inteligjencës së Kosovës (AKI). Qalaj deri më tani ka udhëhequr Departamentin për Operacione në Policinë e Kosovës. Po ashtu, Qeveria ka emëruar Arsim Gërxhaliun edhe për një mandat trevjeçar drejtor të Institutit të Mjekësisë Ligjore (IML). Kurse në pozitën e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës për një mandat trevjeçar është emëruar Ferki Fejza.

Flet për "Epokën e re", Vigan Qorrolli

# LIBE pritet të ketë raport poz



Njohësi i integrimeve evropiane, Vigan Qorrolli, është shprehur i bindur se edhe Komiteti për Liritë Civile, Drejtësi dhe Çështje të Brendshme (LIBE) i Parlamentit Evropian, që do të mblidhet sot (e mërkurë), do të votojë pro liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se në procesin e vendimmarrjes së BE-së për këtë çështje do të ngrihet edhe çështja e ish-prokurorit special Elez Blakaj. Sipas tij, në këtë proces do të ketë shtete që do të diskutojnë për dilemat rreth ndërhyrjes së politikës në drejtësi. Ai ka bërë me dije se BE-ja do t'i liberalizojë vizat jo më herët se në pranverën e vitit 2019. Në këtë intervistë, Qorrolli ka dhënë kritika për sistemin e drejtësisë që, sipas tij, nuk po punohet sa duhet për luftimin e krimit dhe korrupsionit

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 28 GUSHT -

**"Epoka e re":** *Z. Qorrolli, pas dhënies së rekomandimit pozitiv për vizat nga Komisioni Evropian (KE,) më 29 gusht, procesi për vizat e Kosovës do të kalojë në komitetin LIBE të Parlamentit Evropian. Si pritni të shkojë ky diskutim?*

**Qorrolli:** Duke pasur parasysh propozimin pozitiv të Komisionit Evropian për Parlamentin dhe Këshillin muaj më parë, pritet që edhe komiteti LIBE të mërkurën të ketë raport pozitiv për Kosovën. Duhet thënë që në analogji me sistemin parlamentar të Kosovës, ky komitet është komision parlamentar. Komiteti LIBE edhe në vitin 2016 kishte rekomanduar pozitivisht me 25 vota kundrejt 24 kundër dhe 2 abstenimeve. Fatmirësisht, edhe në këtë seancë shumica e anëtarëve të këtij komiteti vijnë nga shtetet që e njohin Republikën e Kosovës brenda BE-së. Puna kolosale e raportueses për Kosovën në PE, znj. Tanja Fajon, duhet përshëndetur dhe besoj se në kuadër të këtij Komiteti LIBE (Komiteti për Liritë Civile, Drejtësi dhe Çështje të Brendshme të PE-së) të ketë diskutime për dhe kundër, por që në fund votimi të jetë pozitiv. Por, mos të krijojmë iluzion që liberalizimi do të ndodhë qysh sot, sepse kjo është vetëm njëra fazë prej disa të tillave të vendimmarrjes së komplikuar të institucioneve të BE-së. Pas kësaj, topi i gjuhet sërish Komisionit Evropian për amendamente të mundshme, pastaj edhe Këshillit të BE-së, dhe vendimi final u takon të dy institucioneve në bashkëvendimmarrje, pra Këshillit të BE-së dhe Komisionit Evropian. Dua të them se institucioni kyç që do ta bëjë liberalizimin për kosovarët është Këshilli i BE-së pasi që ministrat e punëve të brendshme dhe të drejtësisë së vendeve anëtare do ta kenë fjalën kryesore dhe do ta japin votën e tyre finale. Kjo procedurë do kohën e vet dhe nëse gjithçka shkon sipas planit, vendimmarrja do të duhej të përfundonte para fundit të vitit 2018.

**"Epoka e re":** *Meqenëse rekomandimi i KE-së ka qenë pa ndonjë kushtëzim, a është e arsyeshme paraqitja e ndonjë pengese në këtë drejtim?*

**Qorrolli:** Pengesat do të vijnë natyrshëm sikurse nga deputetët anëtarë të LIBE-s që janë nga pesë shtetet mosnjohëse të Kosovës, pra deputetët e PE-së nga Spanja, Rumania, Sllovakia, Greqia dhe Qipro, por edhe ndonjë skeptik tjetër që mund ta lidhë procesin e liberalizimit të vizave me fatin e pasigurt të dialogut politik midis Kosovës

# itiv për liberalizimin e vizave



dhe Serbisë, por edhe me problemet e brendshme të Kosovës në fushën e drejtësisë. Pra, përgjithësisht në atë që njihet si sundim i së drejtës, ku dihet botërisht se Kosova çalon jashtëzakonisht shumë në këtë drejtim dhe ka ndërhyrje të pushteteve të tjera në sistemin gjyqësor dhe atë prokurorial. Fatkeqësisht, nuk ka barazi të pushteteve në Kosovë, meqë politika qëndron mbi ligjin, kjo natyrshëm mund të jetë një sfidë e pakapërcyeshme për disa konservatorë brenda institucioneve të BE-së. Në secilin raport të progresit në dhjetë vjetët e fundit, veçanërisht në raport me Kosovën, BE-ja e thotë qartë këtë gjë: sistemi i drejtësisë në Kosovë nuk është i pavarur, por është i ndikuar nga politika dhe vuan nga paaftësia për t'i ndërtuar institucionet e veta të pavarura nga influenca politike.

**"Epoka e re":** *A mund të ndikojë në këtë proces rasti i dorëheqjes së ish-prokurorit Elez Blakaj, meqenëse edhe kryeministri e ka shprehur këtë shqetësim?*

**Qorrolli:** Ngjarja me ish-prokurorin e Prokurorisë Speciale, Elez Blakaj, sigurisht e ka tronditur sistemin e brishtë të drejtësisë në vend dhe e ka rritur pasigurinë e qytetarëve të Republikës. Abuzimi i politikës dhe politikanëve me gjyqtarë dhe prokurorë ka qenë i ditur, por tashmë është vërtetuar edhe me prova të pakundërshtueshme, siç e thotë edhe BE-ja, se politika i ka futur thellë duart në sistemin e drejtësisë. Një kryeministri në demokraci dhe në sistemin e pushteteve të ndara sigurisht se nuk i takon të diskutojë për çështje që mund të duken në shikim të parë, edhe si procedurale, siç është akti i dorëheqjes nga sistemi prokurorial i një prokurori. Por meqenëse ish-prokurori Blakaj ka ngritur disa pretendime serioze për ndërhyrje të forta politike në sistem, atëherë unë pres që në vendimmarrjen brenda BE-së në çështjen e liberalizimit të vizave të ketë edhe diskutime mbi këtë gjë dhe mund të ketë shtete që do t'i ngrehin këto dilema. Raporti i Qeverisë me prokurorinë dhe gjyqësorin duhet të jetë i pastër dhe të zhvillohet mbi premisat e demokracisë. Pra, një raport i të barabartëve dhe jo raport serviliteti, nënshtrimi dhe ndikimi. Gjithashtu, pres që disa shtete të BE-së ta thonë shumë zëshëm tendencën e politikës për kontroll të drejtësisë dhe kjo mund t'i shtyjë edhe të votojnë kundër liberalizimit, nëse eventualisht e shohin si rrezik tendencën për sundim të drejtësisë nga politikanët e fortë të Kosovës, që shpesh qëndrojnë mbi ligjin. Fatkeqësisht, në Kosovë për t'u emëruar në krye të institucioneve të drejtësisë duhet të ekzistojë një lidhje e fortë politike. Megjithëse në sistem ka burra dhe gra të ndershëm dhe të aftë që çdo ditë luftojnë me pasiguri dhe me intriga, kurse krerët e institucioneve të drejtësisë shquhen për lidhje të forta me politikanë të caktuar.

**"Epoka e re":** *Nëse kjo ndikon në shtyrjen e këtij procesi, kush duhet ta marrë përgjegjësinë?*

**Qorrolli:** Përgjegjësinë duhet ta marrë ai person ose ata persona të cilët bëhen pengesë për liberalizim të vizave dhe ai ose ata nuk mund të jetë askush tjetër përveç politikanëve. Përgjegjësia në radhë të parë i takon Qeverisë dhe Kuvendit si dy motorët e shtetit të Kosovës. Nëse ata vazhdojnë të mos i plotësojnë kushtet e dhëna nga BE-ja për liberalizim, në qoftë se politikanë të caktuar e ndikojnë sistemin e pavarur të drejtësisë, atëherë BE-ja nuk do ta falë këtë gjë dhe do ta vonojë liberalizimin. Një e metë thelbësore dhe e pashmangshme në sistemin tonë, siç tashmë dihet, është fakti i mosluftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit nga ana e sistemit prokurorial dhe gjyqësor. Pavarësisht prej shenjëstrimit të disa rasteve, ato në shkencën juridike njihen si raste të papërfunduara, meqenëse çdo njeri i akuzuar konsiderohet i pafajshëm. Pra, ekziston koncepti i të drejtave të njeriut, që njihet si prezumim i pafajësisë. Me një fjalë, duhet të ketë aktgjykime të plotfuqishme për ta dënuar krimin dhe korrupsionin, për çka nuk mjafton vetëm ngritja e aktakuzave. Një kritikë për sistemin gjyqësor që nuk i shteron mundësitë e veta për t'ua dhënë qytetarëve të Kosovës liberalizimin më shpejt. Pra, është një luftim sipërfaqësor për momentin i krimit dhe jo një luftë rrënjësore për çka do të duartrokitej nga publiku i Kosovës. Në gjendjen të cilën jemi, heronjtë e Kosovës do të duhej të ishin gjyqtarët dhe prokurorët e saj, dhe jo politikanët avangardë mbi ligjin.

**"Epoka e re":** *Po në rast se nuk do të kemi ndonjë shtyrje, kur mund të lëvizin lirshëm qytetarët e Kosovës?*

**Qorrolli:** Shtyrje gjithsesi do të ketë, dhe me një optimizëm të matur do të thosha se me gjithë vonesat dhe rropatjet që po ua bënë padrejtësisht kosovarëve, BE-ja do t'i liberalizojë vizat jo më herët se në pranverë të vitit 2019. Të gjitha parashikimet çojnë nga viti 2019, meqenëse BE-ja në këtë kohë është e orientuar e tëra nga normalizimi i raporteve Kosovë - Serbi, përderisa liberalizimin e vizave, për fat të keq, nuk e ka 'top prioritet'. Pas marrëveshjes Greqi - Maqedoni për ndryshimin e emrit kushtetues të Maqedonisë, kërkesa do të jetë arritja e marrëveshjes ligjërisht detyruese në mes të Kosovës dhe Serbisë, brenda këtij viti, dhe liberalizimi i vizave do të mund të ndodhte brenda muajve të parë të vitit 2019. Edhe për çështjen e kufijve BE-ja po i toleron palët që të flasin për çdo gjë dhe të mos kenë tabu mes vete, por me ndërhyrjen e fuqishme të shteteve gardiane të demokracisë në botë, SHBA-së dhe Gjermanisë, marrëveshje për ndërrim territoresh në Ballkan nuk do të ketë. Vetëm pasi që institucionet e BE-së ta nxjerrin vendimin final, procedurat që zgjasin deri në ditën e udhëtimit të lirshëm për në BE për qytetarët tanë, do të zgjasin nga tre deri në gjashtë muaj. Ky është thjesht parashikim pragmatik i bazuar në procedurat e institucioneve të BE-së dhe praktikës së deritanishme të liberalizimit me vendet e tjera, ndërkaq çdo optimizëm tjetër që vizat do të hiqen më shpejt, është utopi.

# Kosova ka ngecur në zbatimin e MSA-së



**PRISHTINË, 28 GUSHT (ER)** - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pranuar se Kosova ka ngecur në zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA). Në takimin e Këshillit Ministror për Integrim Evropian, që është mbajtur të martën, kryeministri Haradinaj ka thënë se duhet të punohet intensivisht për zbatimin e kësaj marrëveshje. "Kosova punon me BE-në me një kontratë e ajo është MSA-ja. Zbatimin e kësaj e kontrate e kemi ndarë me etapa siç është ERA 1 (Agjenda e Reformave Evropiane). Jemi shumë vonë me MSA-në dhe duhet të punojmë intensivisht për zbatimin e saj. Zbatimi i MSA-së nuk ndihmon vetëm për liberalizim, por edhe për ta siguruar statusin kandidat për në BE", ka thënë Haradinaj. Ai ka deklaruar se duhen identifikuar ngecjet që kanë të bëjmë me zbatimin e Agjendës së Reformës Evropiane në mënyrë që të lëvizet përpara.

Megjithatë, Haradinaj ka vlerësuar se është i kënaqur në përgjithësi me punën që po bëhet në këtë drejtim, duke u bërë thirrje të gjitha dikastereve të përfshira në këtë proces që t'i përshpejtojnë veprimet për zbatimin e plotë të masave të parapara nga Agjenda e Reformave Evropiane, sipas afateve të përcaktuara.

Edhe ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka kërkuar përkushtim më të madh nga ministrat për zbatimin e MSA-së. Sipas saj, qëllimi i këtij takimi ka qenë adresimi i sfidave dhe përmbushja e obligimeve që dalin nga agjenda evropiane dhe përmbushja e obligimeve për MSA-në. Ministrja Hoxha ka treguar se deri në fund të shtatorit dhe fillim të tetorit është planifikuar rishikimi i prioriteteve të ERA-s dhe hartimi i planit të ri të veprimit për vitin e ardhshëm.

## Pakoja e reformës së administratës publik miratohet në mbledhjen e ardhshme të Qeverisë

PRISHTINË, 28 GUSHT - Koordinatori nacional për reforma shtetërore, Besnik Tahiri, ka bërë me dije të martën se në mbledhjen e ardhshme të Qeverisë do të miratohet pakoja e ligjeve të reformës në administratën e shtetit. "Në takimin e Këshillit Ministror për Integrim Evropian u zotuam se Pakoja e ligjeve të reformës në administratën e shtetit do të kalojë në mbledhjen e ardhshme të Qeverisë. Po ashtu, në këtë forum fola për dinamizimin e punës rreth reformave dhe finalizimin e projektligjit për inspektimet e përgjithshme", ka thënë Tahiri.



# Më 4 shtator mbahet seanca e jashtëzakonshme për dialogun



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË 28 GUSHT - Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka treguar se më 4 shtator do të mbahet seanca e jashtëzakonshme për procesin e dialogut Kosovë - Serbi. "Sot kemi mbajtur mbledhjen e grupit parlamentar të LDK-së, ku kemi diskutuar për përgatitjet për seancën e jashtëzakonshme për nxjerrjen e rezolutës që i ndalon presidentit dhe kujtdo tjetër të negociojë për tërësinë territoriale të Kosovës. Seanca do të mbahet më 4 shtator. E mirëpres mbështetjen që po i jepet kësaj rezolute edhe nga grupet e tjera parlamentare. Pres që të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës ta mbështesin këtë rezolutë. Duhet t'i lëmë anash dallimet tona dhe të bëhemi bashkë për ta ndaluar presidentin që ta nxjerrë në pazar territorin e Kosovës", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka shprehur mbështetje për nismën e ndërmarrë për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme për dialogun Kosovë - Serbi dhe ka ftuar të gjitha partitë politike parlamentare të mobilizohen për t'i mbledhur nënshkrimet e nevojshme për të ftuar sa më shpejt këtë seancë.

KDI-ja ka bërë thirrje të vazhdueshme drejtuar deputetëve të Kuvendit të Kosovës për të ftuar seancë të jashtëzakonshme, më 28 maj dhe 17 korrik të këtij viti, duke kërkuar që Kuvendi i Republikës së Kosovës të jetë epiqendra e diskutimeve rreth dialogut Kosovë - Serbi dhe presidenti t'i raportojë Kuvendit. "Republika e Kosovës ka hyrë në fazën finale të dialogut pa një strategji shtetërore të aprovuar në Kuvendin e saj, pa përcaktuar temat e diskutimit, vijat e kuqe, afatet kohore, pritshmëritë e palës së Kosovës në këtë proces dhe pa legjitimuar me anë të një rezolute ekipin udhëheqës të Kosovës në këto bisedime", është thënë në komunikatën e KDI-së.

KDI-ja ka vlerësuar se faza përmbyllëse e dialogut Kosovë - Serbi është duke vazhduar me mungesë të theksuar të transparencës, pa koordinim të spektrit politik, pa koordinim të institucioneve të vendit dhe me veprime të njëanshme të presidentit. "KDI-ja u bënë thirrje institucioneve të vendit ta respektojnë mandatin e Kuvendit të Kosovës si institucioni më i lartë ligjvënës. Institucionet e tjera me veprimet e tyre nuk duhet ta anashkalojnë rolin e Kuvendit në këtë proces të rëndësishëm shtetëror. Ndërsa partitë politike parlamentare, përkatësisht deputetët e Kuvendit të Kosovës, duhet ta respektojnë mandatin dhe kompetencat e tyre, duke ushtruar përgjegjësitë e tyre dhe duke mbajtur sa më parë seancën e jashtëzakonshme për dialogun Kosovë - Serbi", është theksuar në komunikatën e KDI-së. Sipas KDI-së, veprimet e Republikës së Kosovës në këtë fazë kritike të dialogut duhet të koordinohen në Kuvend, duke i dhënë legjitimitet këtij procesi shtetëror përmes miratimit të një rezolute e cila do t'i përcaktojë edhe vijat e kuqe të Kosovës, bashkërendim të institucioneve, gjithëpërfshirje, llogaridhënie dhe transparencë.

## Veseli propozon që "Rruga B" në kryeqytet ta bartë emrin e John McCainit

PRISHTINË, 28 GUSHT (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka propozuar që "Rruga B" në Prishtinë ta bartë emrin e senatorit amerikan John McCain, i cili ka ndërruar jetë në moshën 81-vjeçare. "Javën që shkoi Kosova humbi një prej miqve më të mëdhenj të lirisë dhe të pavarësisë së vet, senatorin amerikan John McCain. Para luftës, gjatë luftës, në ndërtimin e paqes dhe shpalljen e pavarësisë, senatori McCain mbështeti pandërprerë Kosovën. Ne kurrë nuk do ta harrojmë këtë mbështetje. Në nderim të kujtimit të tij, propozoj që 'Rruga B', në kryeqytetin e shtetit tonë, në Prishtinë, ta mbajë emrin e John McCainit. Ata që na u gjetën pranë në kohë të vështira, duhet gjithmonë t'i mbajmë pranë, në zemrat, shtëpitë dhe rrugët tona", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".



# Haradinaj: FSK-ja është e gatshme për tranzicion

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) tashmë është e gatshme për tranzicion dhe për të marrë pjesë në partneritetin për paqe. Këto komente Haradinaj i ka bërë në ceremoninë e ndërrimit të drejtorit të Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s në Kosovë. Kryeministri Haradinaj ka vlerësuar se ka ardhur koha që Kosova nga një absorbuese e sigurisë, të bëhet kontribuuese dhe faktor stabiliteti për siguri



EPOKA E RE Faton DERMAKU

PRISHTINË, 28 GUSHT - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë të martën se Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) është e gatshme për procesin e tranzicionit dhe për të marrë pjesë në partneritetin për paqe. Ai ka vlerësuar se ka ardhur koha që Kosova nga një absorbuese e sigurisë të bëhet kontribuuese dhe faktor stabiliteti për siguri. "Kosova është e zotuar të jetë partnere në politikë, ekonomi dhe në siguri. Për këtë ju konfirmoj të gjithë juve se jemi të gatshëm për tranzicionin e forcës sonë, jemi të gatshëm të marrim pjesë në partneritetin për paqe. Por, jo vetëm në partneritetin për paqe. Ne synojmë t'i bashkohemi NATO-s dhe me këtë konfirmojmë se misioni i NATO-s dhe i KFOR-it respektohet nga njerëzit e Kosovës dhe për ne do të jetë përherë faktor dhe garantues i paqes", ka deklaruar kryeministri Haradinaj në ceremoninë e ndërrimit të drejtorit të Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s në Kosovë (NALT) nga gjenerali Ralf Hoffman te gjenerali Uwe A. Becker. Me këtë rast kryeministri Haradinaj ka falënderuar gjeneralin Hoffmann për punën e deritashme, duke thënë se ishte model për oficerët. Ndërsa i ka uruar mirëseardhje drejtorit të ri të Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s në Kosovë (NALT), gjeneralit Uwe A. Becker, duke i thënë se atë e presin punë të mëdha.

Haradinaj ka rikujtuar se nga viti 1999 deri më sot shumë vajza dhe djem të shteteve të respektuara kanë shërbyer në Kosovë për ta ndaluar tragjedinë, por edhe për ta ruajtur paqen. "Sot jetojmë në paqe. Kosova është shtet paqësor falë shërbimit tuaj dhe ju falënderoj të gjithë juve që keni shërbyer në shtetin tonë gjatë gjithë kohës dhe juve që po shërbeni sot këtu. Ne kemi mësuar se sa e rëndësishme është të mbahet paqja dhe jemi zotuar të qëndrojmë paqësorë dhe të jetojmë në paqe me të gjithë ata që jetojnë në Kosovë, serbë, ashkalinj, romë, egjiptianë, boshnjakë, goranë, por edhe me fqinjët tanë. Ky është zotimi ynë dhe ju falënderoj për gjithë atë që keni bërë për paqen tonë", është shprehur kryeministri Haradinaj. Shefi i Qeverisë ka falënderuar Ekipin Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s në Kosovë (NALT) dhe zyrtarët e saj që shërbejnë në Kosovë, të cilët, sipas Haradinajt, jo vetëm se e kanë ndihmuar FSK-në, por transferuan shpirtin e forcës sonë te shtetet e NATO-s. Haradinaj ka thënë se nesër Forca e Armatosur do të jetë e gatshme t'u shërbejë të gjithë qytetarëve të shtetit tonë dhe me këtë konfirmojmë pjekurinë dhe gatishmërinë tonë që të bëhemi partnerë. "FSK-ja sot është shumetnike. Në të shërbejnë serbë dhe kosovarë, djem dhe vajza të reja. FSK-ja është forcë e të gjithëve që jetojnë këtu. Dhe jo vetëm kaq. Nesër Forca e Armatosur do të jetë e gatshme t'u shërbejë të gjithë qytetarëve të shtetit tonë dhe me këtë konfirmojmë pjekurinë dhe gatishmërinë tonë që të bëhemi partnerë. Për mua sot këtu është dita t'ju falënderoj për punën që keni bërë për sigurinë, stabilitetin dhe qetësinë dhe ta dini se jemi të gatshëm për partneritet", ka theksuar kryeministri Haradinaj.

# Ministri Bytyqi thotë se nuk ka pasur parregullsi në testin e maturës

EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU



PRISHTINË, 28 GUSHT - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka vizituar të martën nxënësit të cilët i janë nënshtruar Provimit të Maturës Shtetërore 2018 në afatin e gushtit, në Gjimnazin "Sami Frashëri" në Prishtinë. Me këtë rast, ministri Bytyqi ka theksuar se testi është shpërndarë me kohë dhe nuk është raportuar për ndonjë parregullsi që do të mund të ndikonte në rezultate. Ai ka vlerësuar ecurinë e këtij procesi si në aspektin e administrimit, po ashtu edhe në marrjen e përgjegjësive të nxënësve. "Nga informacionet që kemi nga qendrat e testimit, nuk ka pasur ngecje në asnjë shkollë. Ka qenë qëllimi ynë që të mos ketë asnjë problem i cili do të ndikonte në rezultate dhe tashmë po vërehet që e kanë kuptuar përgjegjësinë e këtij procesi nxënësit dhe gjithë mësimdhënësit", ka thënë ministri Bytyqi.

Drejtori i Arsimit në Komunën e Prishtinës, Jonuz Salihaj, ka thënë se nuk është vërejtur ndonjë parregullsi në administrimin e testit, duke shtuar se është bërë një punë e mirë në këtë drejtim. "Deri tani çdo gjë ka shkuar në rregull. Besoj se vazhdimisht po shënohen suksese", ka deklaruar Salihaj. Pjesa dytë e provimit në afatin e gushtit do të mbahet më 1 shtator, ndërsa rezultatet pritet të publikohen më 10 shtator.

# Fillon krijimi i policisë së gjelbër që ka për detyrë mbrojtjen e ambientit

PRISHTINË, 28 GUSHT (ER) - Ushtruesi i detyrës së ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Fatmir Matoshi, është pritur të martën në takim nga ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, me ç'rast janë pajtuar për themelimin e grupeve punuese për krijimin e policisë së gjelbër. Me këtë rast, Matoshi ka folur rreth rëndësisë së krijimit të policisë së gjelbër. Ai ka thënë se njësia e policisë së gjelbër ka rol për shqiptimin e gjobave ndaj atyre që hedhin mbeturina në mënyrë të kundërligjshme. "Për një ambient të pastër duhet filluar sa më parë, pasi që ndotja konsiderohet si problemi i dytë kryesor në Kosovë. Në këtë aspekt, si MMPH e kemi vlerësuar të domosdoshëm krijimin e policisë së gjelbër", ka deklaruar Matoshi.

Ndërsa ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, ka mbështetur iniciativën e Matoshit për krijimin e këtij njësiti të gjelbër policor. "Si ministër i MPB-së mbështes këtë iniciativë të domosdoshme. Në këtë aspekt kërkoj nga përfaqësuesit kompetentë të policisë ta shikojnë mundësinë ligjore dhe njerëzore për formimin e një njësiti të tillë", është shprehur Gashi.

Matoshi dhe Gashi janë pajtuar për krijimin e një plani të veprimit si dhe analizimin e modaliteteve të vendeve perëndimore që janë aplikuar në krijimin e policisë së gjelbër. Iniciativa për krijimin e policisë së gjelbër është në kuadër të angazhimeve për pastrimin e vendit, aksion ky i cili fillon më 15 shtator.



# Rritet fondi për mbështetje të projekteve të komuniteteve joshumicë



PRISHTINË, 28 GUSHT (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Skender Reçica, ka pritur të martën në takim grupin e deputetëve përfaqësues të komunitetit joshumicë, Veton Berisha, Emilija Rexhepi dhe Etem Arifi, me të cilët ka diskutuar rreth mbështetjes që kjo ministri është duke u dhënë projekteve kapitale për komunitetet joshumicë.

Fillimisht kësaj ministrie i janë ndarë mjete prej 1.8 milion eurosh për projekte kapitale, "Mbështetje për komunitetet joshumicë" për komunitetin turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptian dhe goran. Në këtë kontekst, ministri Reçica ka njoftuar deputetët se në koordinim me Ministrinë e Financave, këtij fondi i janë shtuar edhe 600 mijë euro duke rritur kështu fondin në 2.4 milionë për mbështetje të projekteve për komunitetet e lartpërmendura. "Me anë të këtij fondi, në bashkëpunim edhe me komunat e Kosovës, po synojmë t'i mbështesim të gjitha projektet e komunitetit turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptian dhe goran. MPMS-ja në kuadër të objektivave të saj për rritje të mirëqenies sociale, po bën përpjekje maksimale për të siguruar mirëqenie të mirëfilltë për të gjitha kategoritë e shoqërisë në vend", ka deklaruar Reçica.

Ndërsa deputetët kanë falënderuar ministrin Reçica për përkrahjen që po ua jep komuniteteve joshumicë, duke theksuar se një mbështetje e tillë i kontribuon sigurimit të një mirëqenie stabile për këto komunitete. Të dyja palët janë pajtuar për thellim të bashkëpunimit edhe në projekte të ngjashme në të ardhmen.

# Obiliqi përfiton 200 mijë euro për ndërtimin e kanalizimit në dy fshatra

PRISHTINË, 28 GUSHT (ER) - Ushtruesi i detyrës së ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka pritur të martën në takim kryetarin e Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, me të cilin kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi për realizimin e projektit "Ndërtimi dhe rregullimi i kanalizimit të fshatit Breznicë-Kozaricë, Obiliq".

Në ceremoninë e nënshkrimit të këtij memorandumi ministri Matoshi ka vlerësuar se ky projekt ka rëndësi të madhe për banorët e këtyre dy fshatrave dhe kap vlerën prej 200 000 eurosh, kurse për këtë vit MMPH-ja këtë projekt e financon në vlerë prej 100 000 eurosh. Po ashtu, Matoshi ka theksuar se do ta mbështesë Komunën e Obiliqit për përmirësimin e gjendjes së mjedisit.

Kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, u zotua se do të angazhohet që ky projekt të realizohet me suksese.



## Rritet interesimi i mërgimtarëve për investime në sektorin financiar



PRISHTINË, 28 GUSHT (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka pritur të martën në takim një grup të mërgimtarëve afaristë nga Gjermania dhe Austria. Ata janë informuar për së afërmi me të gjitha zhvillimet në sektorin financiar, përkatësisht atë bankar dhe për mundësitë për investime.

Guvernatori Mehmeti ka thënë se ky sektor vazhdon të ketë performancë të mirë dhe shkallë të lartë të qëndrueshmërisë. "Zhvillimet pozitive janë duke mundësuar të rritet edhe aktiviteti i sektorit bankar në mbështetje të zhvillimit ekonomik, por edhe rritjes së konkurrencës, për çka edhe Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është e angazhuar", ka thënë Guvernatori Mehmeti.

Grupi i mërgimtarëve afarist falenderuan guvernatorin Mehmeti për pritjen dhe ofrimin e të gjitha informacioneve për zhvillimet në fushat që i mbulon BQK-ja.

# MMPH-ja nxjerr udhëzim administrativ për menaxhimin e resurseve ujore



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka nxjerrë udhëzimin administrativ për procedurat për leje ujore përmes të cilit parashihet hapja e rrugëve për shfrytëzimin racional të resurseve ujore të Kosovës. Po ashtu, ushtruesi i detyrës së ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, në bashkëpunim me Inspektoratin e MMPH-së kanë marrë vendim për rrënimin e objekteve pa leje në zonën e liqenit të Batllavës

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 GUSHT - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka nxjerrë udhëzimin administrativ për procedurat për leje ujore përmes të cilit parashihet hapja e rrugëve për shfrytëzimin racional të resurseve ujore të Kosovës. Me këtë rast, ushtruesi i detyrës së ministrit të MMPH-së, Fatmir Matoshi, ka thënë se ky udhëzim do të krijojë bazë ligjore dhe do të ndikojë në menaxhimin e resurseve ujore. "Udhëzimi administrativ për procedurat për leje ujore do ta rregullojë gjendjen e përgjithshme të menaxhimit të qëndrueshme të resurseve ujore dhe zhvillimin e gjithëmbarshëm ekonomik të vendit duke krijuar kështu bazë të mirëfilltë ligjore për një konkurrencë të denjë për të gjithë pjesëmarrësit në këtë fushë", ka deklaruar Matoshi. Po ashtu, ai ka treguar se ky udhëzim ka për qëllim edhe rregullimin e procedurave aplikuese për akte ujore, strukturimin e procedurave shqyrtuese të kërkesave lëndore për shfrytëzimin e resurseve ujore në aspektin administrativ e teknik si dhe përcaktimin e kritereve shqyrtuese të pakos së dokumentacionit të parashtruara me aplikacion.

Udhëzimi administrativ për procedurat për leje ujore, gjithashtu ka për qëllim krijimin e mekanizmave efikas për mbikëqyrjen e ushtrimit të aktiviteteve të operatorëve në resurse ujore, përmes administrimit sipas detyrës zyrtare, përmes urdhëresës ujore. "Ndër të tjera, ky udhëzim përmban edhe dispozita që përkufizojnë procedurat e veçanta të lëshimit të kushteve ujore, pëlqimit ujor, lejes ujore dhe urdhëresës ujore, pastaj lartësinë e tarifave administrative dhe lejet e operatorit për kyçje në rrjetin e infrastrukturës ujore", është theksuar në komunikatën për medie të lëshuar nga Zyra për Informim e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Udhëzimi administrativ për procedurat për leje ujore është i sistemuar në shtatë kapituj, 36 nene dhe shtatë shtojca që paraqesin në tërësi koherente normative, me qëllim të pasqyrimit adekuat të tërë kompozicionit të udhëzimit dhe qasjes sa më të lehtë për përmbajtjen e tij, duke respektuar parimet themelore të përcaktuara me udhëzim administrativ Nr. 03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative.

## Urdhërohet largimi i objekteve pa leje në zonën e liqenit të Batllavës

Ushtruesi i detyrës së ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, në bashkëpunim me Inspektoratin e MMPH-së, kanë marrë vendim për rrënimin e objekteve pa leje në zonën e liqenit të Batllavës, në rast se subjektet e ndërtimi nuk i largojnë ato në afat prej shtatë ditësh. Ky vendim është marrë pas inspektimeve në terren nga Inspektorati i MMPH-së, i cili ka konstatuar se subjektet që kanë ndërtuar pa leje në zonën e liqenit të Batllavës nuk i janë përmbajtur vendimit të vitit 2017 për largimin e tyre. "Inspektorati i MMPH-së pas inspektimit të datës 14 gusht 2018 ka konstatuar se nuk ka pasur asnjë largim të këtyre objekteve, andaj me këtë rast janë lëshuar 48 vendime për subjektet të cilat kanë ndërtuar në mënyra të paligjshme pranë liqenit të Batllavës", ka thënë Matoshi.

Me këto vendime, sipas Matoshit, janë urdhëruar pronarët e objekteve që në afat prej shtatë ditësh ta bëjnë largimin e tyre. "Po me këto vendime janë urdhëruar që pronarët ta bëjnë edhe rehabilitimin dhe pastrimin e terrenit dhe sipërfaqeve ku janë të vendosura objektet. Në rast se pronarët e objekteve nuk veprojnë sipas vendimeve në fjalë, MMPH-ja do të marrë masa konform ligjeve për rrënimin, largimin e objektit dhe shpenzimet do t'i bartin pronarët e objekteve", ka deklaruar Matoshi.

## Muharremaj gjen në punë vetëm një punëtore në QMF-në e Studenqanit

Suharekë, 28 gusht (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka bërë me dije se gjatë vizitës që i ka bërë të martën Qendrës së Mjekësisë Familjare në Studenqan, në vendin e punës ka gjetur vetëm një punëtore. Muharremaj ka paralajmëruar se do të merren masa ndaj të gjithë atyre që nuk kanë qenë në vendin e punës. "Sapo vizitova Qendrën e Mjekësisë Familjare (QMF) në Studenqan. Përveç Kaltrina Përzhakut, askush nuk ndodhet në vendin e punës në orën 08:00. Do të merren masa menjëherë për zbritje të rrogës dhe masa të tjera. Askush nuk do të lejohet të abuzojë me shërbime publike", ka shkruar Muharremaj në llogarinë e vet në "Facebook".



# Nënshkruhet marrëveshja që ka synim punësimin e të rinjve në Kaçanik

Kaçanik, 28 gusht (ER) - Nënkryetari i Komunës së Kaçanikut, Ylber Bajra, dhe Shqipe Breznica, koordinatore e projektit nga organizata "Help", kanë nënshkruar një marrëveshje të bashkëpunimit në kuadër të programit trajnues: "Programi i trajnimit për vetëpunësim". Ky program është i financuar nga projekti i USAID-it EMPOWER sektori privat, në partneritet me Agjencinë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA). Në bazë të marrëveshjes së arritur, Komuna e Kaçanikut dhe organizata "Help" do të bashkëpunojnë me qëllim të nxitjes së punësimit dhe ndërmarrësisë tek të rinjtë e cenueshëm dhe me mundësi të kufizuara ekonomike të kësaj komune.
Gjithashtu, Komuna e Kaçanikut do ta bashkëfinancojë këtë program lidhur me aktivitetet që do që do të zhvillohen në këtë komunë. "Programi i trajnimit për vetëpunësim" mbështetet në idenë se përkrahja e të rinjve të Kosovës në ndërmarrësi ua mundëson atyre t'i zhvillojnë shkathtësitë që do t'i rrisin mundësitë e tyre për punësim dhe jetesë të qëndrueshme. Përveç Komunës së Kaçanikut, ky program do të zbatohet edhe në Gjilan, Han të Elezit dhe Viti. "Programi i trajnimit për vetëpunësim" do të zbatohet nga "Help" gjatë 15 muajve të ardhshëm.




# Pajtohen për bashkëpunim në të mirë të kategorive të dala nga lufta e UÇK-së



Malishevë, 28 gusht (ER) - Komiteti për Familje të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve të Luftës së UÇK-së si dhe Martirë të Luftës, nën udhëheqjen e kryetares së këtij Komiteti, Vlorë Manaj-Krasniqi, kanë vizituar shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së në Komunën e Malishevës.
Manaj-Krasniqi është zotuar se do të bashkëpunojë me të gjitha kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së. "Do të bashkëpunoj me të gjithë sepse dëshmorët janë të të gjithëve. Për mua është sakrificë dhe motiv për një punë të mirë dhe shërbime për këtë kategori më meritore të shoqërisë sonë", është shprehur ajo.
Ndërsa Refki Morina, sekretar i Shoqatës së Veteranëve të UÇK-së në Malishevë, ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim me këtë komitet edhe për të ardhmen, në mënyrë që të ndihmohen kategoritë e dala nga lufta e lavdishme e UÇK-së. Në këtë takim anëtarët e këtij komiteti janë zotuar se shumë shpejt do t'i prezantojnë kërkesat e tyre të cilat do t'ua prezantojnë institucioneve komunale dhe shoqatave të dala nga lufta çlirimtare.

## Vazhdon rregullimi i ndriçimit publik në Skenderaj

Skenderaj, 28 gusht (ER) - Komuna e Skenderajt është duke vazhduar ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve sa i përket ndriçimit publik. Kompania "Al Trade", e kontraktuar nga Komuna e Skenderajt, për rregullim të sistemit të ndriçimit publik ka dalë të martën në terren me qëllim që t'i sanojë defektet që janë shfaqur në disa shtylla elektrike në lagjen afër Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare. "Punëtorët e kompanisë janë parë te punojnë në rregullimin e disa shtyllave me ndriçim elektrik në infrastrukturën, duke bërë funksionale 27 shtylla elektrike të sistemit ndriçimit publik, si dhe janë funksionalizuar edhe dy shtylla të tjera që nuk kanë qenë në funksion që 18 vjet. Puna do të vazhdojë deri në rregullimin e plotë të ndriçimit publik brenda qytetit", është thënë në njoftimin e Komunës së Skenderajt.



Krejt njëjtë! (2)

# Partitë politike vazhdojnë të udhëhiqen nga parimi i interesave të ngushta partiake

*Komandantë të UÇK-së, deputetë e qeveritarë, kryetarë partish politike, kryetarë komunash, gazetarë, prokurorë gjykatës, qytetarë…!*



YLBER ÇITAKU

Në pamje të parë ose shprehur popullorçe, "shikuar me syrin e lirë", çdo gjë ishte dhe është në rregull, mirëpo kur gjërat shikohen më në brendi pothuajse gjithë çfarë ndodh rreth zgjedhjeve dhe institucioneve që dalin nga to bëhet me djallëzi e kalkulime politike, pothuajse asnjëherë për interesin e qytetarëve e të vendit. Qytetari thuajse e ka të pamundur t'i kuptojë këto lojëra e djallëzi të njerëzve nga politika, e si t'i kuptojë qytetari kur me shumë vështirësi po i përballon sfidat e jetës, sfida këto që përballimi i tyre po bëhet çdo ditë e më i vështirë.

Partitë politike pa dallim udhëhiqeshin dhe vazhdojnë të udhëhiqen nga parimi i interesave të ngushta partiake pa e parë interesin e përgjithshëm të vendit, të njëjtat nëse ishin në pushtet votonin gjithë çfarë u shërbehej, ato të opozitës kundërshtonin gjithë çfarë propozohej pa e shikuar interesin e përgjithshëm të vendit. Raste të tilla ka shumë. Por, dy prej rasteve më eklatante janë propozimi për formimin e ushtrisë së Kosovës, i kundërshtuar nga LDK-ja dhe demarkacioni me Malin e Zi, fillimisht i kundërshtuar nga AAK-ja sa ishte në opozitë, por që e votoi menjëherë porsa erdhi në pushtet. Thjesht, u humbën më shumë se dy vjet dhe u votua nga ata që e kundërshtonin me kërcënim deri në thirrje për luftë qytetare. Këto dhe raste të ngjashme janë treguesi më i mirë se partitë politike në Kosovë i përmbahen me fanatizëm thënies popullore "Për inati të resë më vdektë djali"!

Përbërja e Kuvendit të Kosovës në vend të përmirësimit në kuptim të cilësisë ka shkuar drejt degradimit, deputetët e përbërjes aktuale tallen me institucionin ku janë anëtarë, tallen me qytetarin e Kosovës, tallen me çdo gjë që ka të bëjë me Kosovën. E ku ka tallje më të madhe sesa të mos bësh asgjë, madje as të marrësh pjesë në ndejat (seancat) e asgjësë dhe jo vetëm që shfrytëzon përfitimet që i takojnë një deputeti të përgjegjshëm, por kërkojnë me ngulm ngritjen e pagave dhe shtimin e përfitimeve.

Deputetët e pozitës tregojnë papërgjegjësi prej diletantëve, kjo papërgjegjësi e tyre nuk është as e rastësishme, as individuale. Thjesht, është e orkestruar nga grupe të caktuara të interesit të cilat përmes metodave krejt primitive të bojkotimit të seancave në heshtje dëshirojnë ta përcjellin mesazhin e mundësisë së rebelimit tek liderët e tyre partiakë, kurse ata të opozitës tregojnë papërgjegjësi prej adoleshentëve duke refuzuar votimet e ligjeve e të rezolutave me pretekstin se ne nuk ia bëjmë numrat pozitës, sikur numrat qenkan më me rëndësi dhe më me interes për vendin sesa përmbajtja e ligjeve apo rezolutave.

Qeveritë si institucione ekzekutive që nga pas lufta krijoheshin si me rotacion PDK, AAK e LDK, por që në shumicën e rasteve sikur kishin mision të punonin kundër interesave të popullatës shumicë të Kosovës dhe të vet Kosovës si shtet në ndërtim e sipër.

Se qeveritë me veprimet dhe mosveprimet e tyre kanë punuar në vazhdimësi kundër interesave të qytetarëve dhe të vendit këtë e di secili qytetar i Kosovës, madje qytetarët ndihen të stërlodhur nga këto veprime kriminale të qeveritarëve tanë, andaj ka kohë që kanë filluar për të mos iu dhënë vëmendje veprimeve të tilla, megjithatë me këtë rast po i përmendi vetëm dy raste të qeverisë së fundit që janë skandale të përmasave botërore: - Pesëdhjetë e dy milionë euro (52 000 000 euro) dhënë fillimisht për "Bechtel-Enka", por që dedikimi final i pjesës më të madhe të kësaj shume shkon…! Ku është prokuroria? - Gjuha e të parit të Qeverisë, hajn ky e hajn ai, për të mos e harruar sjelljen e tij prej një huligani në përvjetorin e sivjetmë të lidhjes së Prizrenit, shtrohet pyetja ku është qytetaria.

### Liderë të partive politike

Kosova pas luftës kishte dy liderë partish dominuese dhe dy-tri parti të vogla pa ndikim (LB, PSD, PP), kështu vazhdoi derisa partive dominuese iu deshën parti satelit, në momentin kur ato e vërejtën se kanë nevojë për parti satelit krijuan satelitët e tyre ose krijuan satelitë në taborin e rivalit politik, të tilla ishin disa e disa vazhdojnë të jenë si: ORA, LDD, FER-i, AKR, LV, Nisma, Alternativa, PSD e tanishme etj.

Por që pothuajse pa përjashtim këto parti kanë liderë me ngjashmëri të papërshkrueshme në sjellje, kulturë, edukim, traditë, ego, injorancë e inate dhe rrjedhimisht kemi: Liderë partie me strukturë deri në 50 % familjarë; liderë partie me struktura udhëheqëse lokaliste; liderë partie ku më shumë ka hapësirë e ndikim shoferi sesa njeriu me bagazh intelektual; liderë partie ku më shumë ka hapësirë e ndikim kamerieri sesa njeriu me vlera e bagazh kombëtar; liderë partie ku më shumë ka hapësirë e ndikim sekseri sesa njeriu me vlera e bagazh prej akademiku; liderë partie ku më shumë kanë hapësirë e ndikim shoferi, kamerieri e sekseri sesa njerëzit me vlera, bagazh e kontribut intelektual, kombëtar e partiak; liderë partie tek i cili, pavarësisht prej vlerave dhe bagazhit intelektual e kombëtar, pavarësisht prej autoritetit e votave që mund të ketë individi, po nuk diti të merret me intriga, shpifje, insinuata e mbi të gjitha po nuk diti të vardiset e ardhmja e tij në politikë është e paperspektivë.

### Kryetarë komunash

Në Kosovën e pasluftës mbahen zgjedhje të veçanta çdo katër vjet për kryetar komune, rreth 50 % e popullatës me të drejtë vote dalin të votojnë, madje në shumicën e rasteve dilet të votohet dy herë për shkak të sistemit zgjedhor, por shumica e zotërinjve që kandidohen për kryetarë komune (përjashto kryetarët e Hanit të Elezit, z. Rufki Suma, atë të Fushë-Kosovës, z. Burim Berisha, atë të Shtimes, z. Naim Ismajli dhe ndonjë rast tjetër eventual) assesi ta kuptojnë se kanë kandiduar dhe se janë zgjedhur për kryetar të komunës përkatëse.

Detyra parësore e tyre është mirëmbajtja dhe rregullimi i infrastrukturës brenda kufijve të komunës, por si të "gjithëditur" që janë merren jo vetëm me çështjet madhore të vendit, por shkojnë aq larg saqë merren edhe me zgjidhjen e problemeve globale, raste më të shpërfaqura janë Shpend Ahmeti, Agim Bahtiri e Lutfi Haziri, infrastruktura e komunave në të cilat janë kryetarë është për keqardhje.

### Gazetarë

Qytetari i Kosovës pas lirisë së fituar më së shumti ka pasur nevojë të jetë i informuar, nuk thuhet sa për t'u thënë "Njeriu më i pasur është ai që ka informatën". Popullata kishte nevojë të informohej për ndodhitë gjatë luftës, për të vrarët, për të zhdukurit, për të dhunuarit, për dëmet e luftës, po edhe për zhvillimet e pasluftës.

Me segmentin e gazetarisë çalonim si shoqëri edhe për faktin se që nga vitet '80-ta regjimi shovinist serb u përkujdes që këtë segment të rëndësishëm ta ngufatë, kurse në vitet '90-ta nuk hezitoi t'i mbyllë me qëllimin e vetëm që shqiptarëve të Kosovës t'ua mbyllin dritaret e informimit.

Me ardhjen e lirisë në verën e vitit 1999 filluan të hapeshin dritare informative në vend, popullata i dëgjonte, i lexonte këto media, ishte normale që qytetarët t'u besonin këtyre medieve, rrjedhimisht opinioni për të "vërtetën" krijohej duke dëgjuar e lexuar këto media.

Para disa vjetëve Milaim Zeka, atëherë kur ishte edhe vetë gazetar, pati thënë: "Gazetarët e Kosovës qkul…. për një pasul", pra e kishte fjalën se gazetarët e Kosovës shiten e blihen për një fasule.

Me qenë i sinqertë në atë kohë nuk i kam besuar Milaimit, thjesht kam menduar që mund të ketë individë të tillë, por që besoja se shumica e gazetarëve janë njerëz që punojnë me përkushtim e profesionalizëm në profesionin e tyre si gazetarë.

U deshën të kalojnë disa vjet nga kjo deklaratë e Milaimit që unë ta besoj, e si mos ta besoj kur edhe vetë Milaimi u qkul… jo për një fasule, sepse shifrat dhe rrethanat kishin evoluar, por për përfitime personale më të larta nuk zgjodhi mënyra e metoda, për të përfituar ai u mor me shumë çka, por jo me gazetari hulumtuese, segment ky ku, sipas bindjeve të mia, Milaimi ka shkëlqyer!

Fat i madh do të ishte sikur të ishte Milaimi i vetmi, por pothuajse që të gjithë gazetarët e njohur u futën nën kthetrat e politikës e të bizneseve të dyshimta e të pista, madje ca nga ta kanë avancuar në pronarë, drejtorë e aksionarë mediesh e kompanish prej gurthyesve, hoteleve e deri tek bordelet gjysmësekrete.

Këto pozita e favore iu dhanë gazetarëve vetëm e vetëm që ta mbyllin gojën. Disa nga gazetarët këto pozita i përvetësuan duke hyrë në partneritet me politikanë, komandantë, prokurorë, gjyqtarë e biznesmenë, kuptohet me "marrëveshje e mirëkuptim".

Shtrohet pyetja: Po me çka imponoheshin këta gazetarë për t'u bërë aksionarë në politikë, biznese dhe organe vendimmarrëse? Po i prezantoj dy-tri "tema" të përdorura nga gazetarët për t'u imponuar.

- Politikanët, komandantët, prokurorët, gjykatësit, pronarët e bizneseve shantazhoheshin me publikimin e aferave të tyre korruptive; Politikanët, komandantët, prokurorët, gjykatësit, pronarët e bizneseve shantazhoheshin me publikimin e veprime të tyre imorale; Politikanët, komandantët, prokurorët, gjykatësit, pronarët e bizneseve shantazhoheshin me publikimet e dukurive devijante në veprimet dhe veprimtarinë e tyre.

Ka pasur shumë raste kur politikanët, komandantët, prokurorët, gjykatësit e pronarët e bizneseve, pasi binin pre e shantazheve, fillonin të ngadhënjeheshin nga gazetarët për publikime dhe prezantim në kontest pozitiv të veprimtarisë së tyre, po edhe të vetë atyre si individë, vetëm se duheshin të ndanin diçka nga pasuria e tyre për këta gazetarë. **(Vijon)**

## Rusia zhvillon manovra të mëdha ushtarake në shtator



**Moskë, 28 gusht** - Rusia do t'i mbajë muajin e ardhshëm manovrat më të mëdha luftarake në gati katër dekada, tha të martën ministri i Mbrojtjes Sergei Shoigu.
Në manovra do të marrin pjesë edhe forca kineze dhe mongole.
Manovrat e koduara me emrin 'Vostok-2018' do të përfshijnë rreth 300 000 trupa, mbi 1 000 avionë ushtarakë, dy nga flotat detare ruse dhe të gjitha njësitë ajrore të saj, tha ministri Shoigu.
Manovrat zhvillohen në një kohë kur janë rritur tensionet midis Perëndimit dhe Rusisë, e cila është e shqetësuar rreth asaj që e quan një përforcim të pajustifikuar ushtarak të NATO-s në krahun e saj perëndimor.
NATO-ja thotë se i ka shtuar forcat e saj në Evropën Lindore për të penguar një veprim të mundshëm ushtarak rus pas aneksimit të Krimesë nga Moska dhe mbështetjes prej saj të një rebelimi pro-rus në Ukrainën Lindore.
Kina dhe Rusia kanë marrë pjesë edhe më parë në stërvitje të përbashkëta ushtarake, por jo në një shkallë kaq të madhe. Një zëdhënësi i NATO-s tha se Rusia e kishte informuar Aleancën rreth manovrave dhe se NATO-ja do t'i vëzhgojë ato.

# Misioni i OKB-së rekomandon akuza për gjenocid ndaj gjeneralëve të Myanmarit

Në gusht të vitit 1968 tanket sovjetike sulmuan Çekosllovakinë komuniste. Qeveria sovjetike i siguroi qytetarët e saj se trupat ishin atje për të ofruar "ndihmë miqësore"



**Pragë, 27 gusht** - Pesëdhjetë vjet më parë Bashkimi Sovjetik i atëhershëm tronditi botën duke pushtuar aleaten e vet komuniste, Çekosllovakinë. Por, në Moskë, pushtimi sovjetik nxiti një protestë që do të bëhej një moment i rëndësishëm për të drejtat e njeriut në Rusi dhe në lëvizjen pro-demokracisë. Në gusht të vitit 1968, tanket sovjetike sulmuan Çekosllovakinë komuniste. Qeveria sovjetike i siguroi qytetarët e saj se trupat ishin atje për të ofruar "ndihmë miqësore". Por pushtimi shkaktoi dëshpërim mes aktivistëve rusë pro-demokracisë, të cilët, me goditjen në Pragë, panë një nxitës për represion të mëtejshëm në vend.
Kishte shpresë se Çekia do të fillonte disa reforma të cilat do të ndihmonin jo vetëm çekët, por edhe ne në Rusi, nëse do të zbatoheshin.
Pavel Litvinov, atëherë një fizikan 28-vjeçar, ishte një nga tetë rusë të cilët fshehurazi u drejtuan te Sheshi i Kuq në Moskë për ta shprehur mbështetjen për shokët e tyre çekë dhe sllovakë. Ndërsa ora e Kremlinit shënoi 12, ata shpalosën një pankartë ku shkruhej: "Për lirinë tuaj dhe tonën".
Demonstrata zgjati vetëm pak minuta para se të ata të rriheshin dhe të ndaloheshin nga policia. "Nuk kisha asnjë dyshim, dhe prisja shtatë vjet kamp pune si shumë nga miqtë e mi për të ashtuquajturën propagandë antisovjetike", thotë Litvinov.
Litvinov u dënua me pesë vjet punë të detyruar në një kamp minierash siberiane. Ai më vonë emigroi në Shtetet e Bashkuara.
Demonstruesit e tjerë u përballën me një fat të ngjashëm ose u shtruan në reparte psikiatrike sovjetike. Por ai ishte një moment përcaktues për lëvizjen disidente dhe pro-demokracisë që do të vinte. "Njerëzit jo më kot shkuan në burg apo në mërgim. Ai nuk ishte thjesht një demonstrim i vetëm që të gjithë e harruan shpejt. Ajo rezonoi shumë", thotë Ksenia Sakharnove, drejtoreshë e dokumentarit "5 minuta liri".
Megjithatë, sot, anketat tregojnë se pothuajse gjysma e të gjithë rusëve nuk janë në dijeni të pushtimit të vitit 1968 - dhe aq më pak për protestën në Sheshin e Kuq që pasoi. "Njerëzit 35 vjeç apo më të rinj nuk dinë asgjë për këto ngjarje, por ajo ka rëndësi ndërkombëtare. Që nga ai moment, Bashkimi Sovjetik filloi të zhdukej dhe njerëzit filluan të bëheshin më të lirë", thotë 19 vjeçja Alisa.
Bashkimi Sovjetik nuk ekziston më prej kohësh, por presioni i shtetit ndaj opozitës dhe kritikëve të Qeverisë në Rusi nuk është gjë e së kaluarës.
Në luftën aktuale të Kremlinit në Ukrainë dhe kufizimin e lirive politike, anëtarët e familjeve të demonstruesve të Sheshit të Kuq shohin ngjashmëri me atë që ndodhi në vitin 1968. "Nëse atëherë historia ishte se si Çekosllovakia kishte liritë dhe i humbi nën tanke, sot historia është se si rusët fituan lirinë dhe më pas e humbën, ose po e humbasin. Dhe përsëri ka tanke - jo në Sheshin e Kuq, ata janë tani në Ukrainë dhe në Krime", thotë Yaroslav Gorbanevsky, djali i protestueses Natalya Gorbanevskaya.
Në një ceremoni për ta shënuar protestën e vitit 1968 në Sheshin e Kuq, Litvinov bëri thirrje për lirimin e të burgosurve të sotëm politikë, ndërsa policia ndërhyri ndaj dy demonstrueseve.

# May: Brexiti pa marrëveshje nuk është fundi i botës



**Londër, 28 gusht** - Kryeministrja britanike, Theresa May, ka thënë se dështimi për të arritur marrëveshje me Bashkimin Evropian para se Britania të largohet nga blloku vitin e ardhshëm "nuk nënkupton fundin e botës", transmeton "Reuters".
May ka bërë këto komente teksa është nisur drejt Afrikës për t'i rritur lidhjet tregtare me Britaninë, pak para Brexitit që është planifikuar të ndodhë në muajin mars të vitit 2019.
Ndërkohë ministri britanik i Financave, Philip Hammond ka thënë javën e kaluar se një largim nga BE-ja pa marrëveshje do t'i dëmtonte financat publike të Britanisë.
Para se të arrinte në Afrikën Jugore, May ka thënë se parashikimet e cituara nga Hammond janë të vjetruara tashmë. Ajo ka përsëritur komentet e bëra nga udhëheqësi i Organizatës Botërore për Tregti (WTO), se nëse Britania largohet nga BE-ja pa pakt nuk "do të jetë e lehtë", mirëpo ajo nuk nënkupton "fundin e botës".
May është duke shpresuar në arritjen e një marrëveshjeje "të favorshme" me BE-në në çështjet kyçe të tregtisë, të cilat kanë ndarë partinë e saj në mes të atyre që duan ndarje definitive nga blloku dhe pjesës tjetër që kërkon lidhje të forta me vendet evropiane.

## Brukseli dhe Roma përballen për emigrantët

**Bruksel, 28 gusht** - Italia ka kërcënuar se do t'i pengojë anijet e forcës detare të Bashkimit Evropian që të sjellin në portet e saj emigrantët që marrin në Mesdhe, nëse BE-ja nuk gjen mënyrën për të ndarë barrën, thanë zyrtarët në Bruksel.
Diplomatët u takuan të martën në Bruksel për të diskutuar rreth kërcënimit të Italisë, qeveria populiste e të cilës ka mbajtur në det me ditë të tëra disa anije shpëtimi me qindra emigrantë në bord.
Zyrtarët e Bashkimit Evropian thanë se Roma i ka dhënë afat Bashkimit Evropian deri në fund të gushtit për të dalë me një skemë të qartë transferimi për emigrantët e shpëtuar në det me anijet e forcës së përbashkët detare të operacionit Sophia. Përndryshe, thotë Italia, anijet nuk do të lejohen më në portet e saj.
Nuk ka gjasa të arrihet një marrëveshje e shpejtë që vendet e tjera të BE-së të marrin njerëzit e shpëtuar nga anijet e operacionit Sophia. Vendet e Bashkimit Evropian nuk kanë mundur të bien dakord mbi politikën e migrimit në kushtet kur numri i migrantëve dhe refugjatëve nga Lindja e Mesme dhe Afrika është rritur ndjeshëm.



Reportazh / Durrësi në fundgusht, më i frekuentuar se asnjëherë

# Pusho bukur dhe shqip

**Durrës, 28 gusht** - Ndonëse temperaturat kanë rënë paksa, në Durrës vazhdon të rritet fluksi i pushuesve nga Kosova. Gëzimi, i cili drejton një hotel në këtë qytet, thotë se një gjë e tillë nuk është parë viteve të mëhershme. "Janë dy faktorë. E para, koha ka qenë shumë e mirë. Temperaturat e fundgushtit, prej vitesh nuk kanë qenë kaq të larta dhe e dyta, kushtet në Durrës vijnë e përmirësohen si në drejtim të cilësisë së shërbimeve, po ashtu



edhe çmime favorizuese për pushuesit", ka thënë Gëzimi. Ai ka shtuar se pushuesit kanë qenë jo vetëm shqiptarë, por edhe boshnjakë e maqedonas. Korriku, sipas Gëzimit, ka qenë me shi, ndërsa në qershor është punuar me grupe/ekskursione, ndërkaq fluksi tash është befasues.
Çifti nga Peja, Shpresa dhe Gazi Thaçi kishin zgjedhur fundin e gushtit për të pushuar bashkë me fëmijët e tyre. Duke konsideruar se mund të kishte vende të lira si përherë në Durrës, ata nuk kishin bërë rezervime të hotelit më parë. "Mezi gjetëm dhe u akomoduam në një hotel. Dhe jemi mirë këtu", ka thënë çifti nga Peja.
Më tutje, Gëzimi ka treguar se, përveç në hotele, vend të lirë nuk ka as në sektorin privat. "Edhe pse e hëna gdhiu e vranët, kishte ardhje enorme në Durrës. Nga nesër do të ketë përsëri diell dhe si duket kosovarët vijnë më të madhe këtu për shkak se përfundon pushimi veror i fëmijëve", ka thënë ai.
Në hotelin "Al-Mar" te Shkëmbi i Kavajës, mysafirët ktheheshin sepse nuk gjenin vende të lira. Kishin ardhur edhe çifte nga diaspora të moshave dhe të kategorive të ndryshme, por dominonin pushuesit nga Kosova. Halil Dërguti, avokat nga Mitrovica, kishin ardhur bashkë me zonjën. "Unë vij zakonisht në Durrës, është i frekuentuar, i lirë dhe komod. Për herë të parë jam në këtë hotel dhe në këtë zonë dhe do të rrija edhe më gjatë sikur të mos kisha seanca gjyqësore", ka thënë ai. Edhe Dërguti mbetet i habitur se sa shumë mysafirë ka në këtë periudhë në bregdetin shqiptar. "Kam biseduar me disa që vijnë në këtë zonë dhe janë të kënaqur. Ndoshta menaxhmenti i hotelit dhe stafi janë shumë korrekt, por vërtet kemi kaluar një pushim për t'u mbajtur mend", ka thënë Dërguti.
Edhe zonja e tij, Xhevahirja, ishte e kënaqur me këtë pushim dhe mikpritjen shqiptare. "Përpara kemi qenë në Ulqin dhe në Greqi, por tashmë Durrësin nuk e ndërrojmë me asnjë tjetër", ka theksuar ajo.
Menaxheri i hotelit "Al-Mar" ka thënë se fluksi i pushuesve në shtator varet shumë edhe nga moti që do të mbretërojë gjatë kësaj periudhe. "Do të punojmë me grupe dhe ekskursione, me nxënës dhe me kategori të tjera. Kemi bashkëpunim me agjenci të ndryshme në Kosovë si me 'Sharr Travell', por edhe me të





tjera", ka theksuar ai.
Arbani dhe e fejuara e tij, Elina, kishin ardhur nga Gjermania për të kaluar një javë në Durrës. "Mund të thuhet edhe se është turizëm patriotik, pse jo. Kemi nevojë të paktën një javë në vit, qind për qind të jetojmë, të dëgjojmë, të mendojmë e të pushojmë shqip", ka thënë Arbani, ndërsa Elina, e lindur dhe e rritur në Gjermani, ka thënë: "Prej që jemi në lidhje kemi pasur disa udhëtime bashkë, por përherë një javë në vit e ndajmë për bregdetin shqiptar". **(N. B.)**

# ‘My short words’ fiton çmimin e parë në ‘Hyjnesha në Fron’ 2018

**Prishtinë, 28 gusht (ER)** - Më 27 gusht në stacionin e trenit në Prishtinë është mbajtur ceremonia përmbyllëse e edicionit të 11-të Fest Film Kosova 2018.
Ceremoninë e shpalli të hapur me një fjalë hyrëse drejtoresha ekzekutive e festivalit Makfire Miftari, e cila më pas ka shpalosur edhe emrat fitues të festivalit të sivjetmë të filmit Fest Film Kosova 'Hyjnesha në Fron' 2018.
Ky edicion kishte një program mjaft të pasur me kategori të ndryshme filmash, të shkurtër, të mesëm, dokumentar, të gjatë dhe për fëmijë.
Gjithashtu, pjesë e këtij edicioni ishin edhe punëtori të ndryshme profesionale dhe një ekspozitë.
Filmat u shfaqën në tri kinema; në vagon treni statik, në stacion të trenit dhe në kino Armata.
Mbrëmja e fundit pas ceremonisë së çmimeve u pasua me një koktej për të pranishmit dhe muzikë të lehtë qytetare live nga Bashkim Gagica.
Juria në përbërje të artistëve: Edwin Mingard (filmbërës, Mbretëri e Bashkuar), Mark Norfolk (regjisor, Mbretëri e Bashkuar), Agim Sopi (regjisor, Kosovë), Kimete Berisha (publiciste, Kosovë), Naser Shatrolli (dramaturg, Kosovë) dhe Yll Berisha (regjisor, Kosovë) në kategorinë e filmave të gjatë me çmimin kryesor të festivalit e shpërblyen filmin me regjisor dhe produksion turk 'My short words' (Fjalët e mia të shkurtra).



E rrallë

## Gruaja drejt verbimit, burri 84-vjeçar mëson si ta lyejë



Thuhet se dashuria qëndron në gjërat e vogla. Këtë gjë e tregon më së miri historia e Mona dhe Des Monahan, burrë dhe grua irlandez ajo 83-vjeçare dhe ai 84-vjeçar, të martuar prej 57 vjetësh. Mona është duke u verbuar për shkak të përkeqësimit të ndjeshëm të shikimit dhe Des, prandaj ka nisur të mësojë se si ta lyejë.

FOTO E DITES



Papa Francesko, pjesë e meshës në Parkun e Phoenixit në Dublin, Irlandë. /AP/

E jashtëzakonshme

## Panda më e famshme në botë, piktore



Mund të konsiderohet pa frikë artistja më e këndshme e Vjenës, një panda femër 18-vjeçare ka marrë famën me dhuntinë e jashtëzakonshme të saj, pikturën. Falë Yang Yang, kopshti zoologjik që e strehon ka mundur të tërheqë vizitorë të shumtë, që të gjithë kureshtarë për pikturat e vogla, nga të cilat deri tani janë shitur në internet 100 copë për 490 euro secila.

BARSOLETA E DITËS



**E dashura: Zemër, çfarë të kujton shiu që po bie?**
**I dashuri: Nënën time duke vrapuar për t'i heqë teshat nga vigu.**

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Vetem gjate vikendit**
**në ora 16:00**

### " INCREDIBLES 2" 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

**Rolet:** Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

**Regjia:** Brad Bird







**Në ora 18:20**

### "FUTURE WORLD"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

**Regjia:** James Franco

**Në ora 20:00**

### "ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

**Rolet:** Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

**Regjia:** Peyton Reed






**Në ora 22:00**

### "LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

**Rolet:** Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

**Regjia:** Fernando León de Aranoa

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Në familje po prisni një zhvillim të rëndësishëm. Jeni të mbërthyer nga një ankth i pashpjegueshëm.



**DEMI**
Këto ditë keni vendosur të ndryshoni pritshmëritë për një projekt të nisur. Mos prisni shumë të mos zhgënjeheni më pas.



**BINJAKËT**
Partneri ju ka shprehur një shqetësim që për momentin mund të zgjidhet. Mos e lini pas dore.



**GAFORRJA**
Keni filluar të kërkoni në të kaluarën tuaj për fakte dhe persona që ju interesojnë për momentin.



**LUANI**
Keni një karrierë të suksesshme që po mundoheni ta shfrytëzoni edhe për përfitime financiare. Në këtë fushë duhet të prisni pak më shumë.



**VIRGJËRESHA**
Në shumë çaste mund të ndiheni keq dhe kjo mund t'ju bëjë të thoni gjëra për të cilat do të pendoheni më pas.



**PESHORJA**
Edhe pse sot do të ketë shumë situata negative, ju nuk do të lejoni në asnjë moment t'jua prishin ditën dhe qetësinë tuaj.



**AKREPI**
Sot duhet të jeni më tolerant me të tjerët. Një fjalë e thënë me tepër mund të shkaktojë konflikt me një mik të mirë.



**SHIGJETARI**
Emocionalisht ndiheni të përmbushur dhe kjo gjë ju sjell në humor. Do të vëreni disa probleme të vogla gjatë ditës.



**BRICJAPI**
Dikush ka nxjerrë anën më të keqe tuajën sot. Për këtë arsye do të jeni mjaft të ashpër edhe me persona që nuk e meritojnë.



**UJORI**
Nëse ka ardhur koha të zbuloni një sekret, merrni me parë miratimin e personave që kanë lidhje me të.



**PESHQIT**
Çdo gjë që keni vendosur të bëni sot do të jetë pikërisht siç e kishit menduar. Dhe, pse ngurroni, dikush do t'ju mbështesë.

# Isaacu përgatit pasta për Duan




Dua duket se është me fat. I dashuri i saj, Isaac Carew, përpos që e shoqëron në secilin udhëtim, ai edhe ka përgatitur ushqim për të. Duket se Duas i pëlqejnë pastat, meqë ai i ka bërë me shumë dashuri për atë.

# Jennifer Lawrence, dorë për dore me të dashurin në New York



Jennifer Lawrence dhe i dashuri i saj Cooke Maroney duket se janë më të dashuruar se kurrë. Fituesja e çmimit Oscar dhe tregtari i veprave të artit janë parë dorë për dore në një takim në Nju Jork.

Aktorja e Red Sparrow dukej e veshur shumë sportive, me një xhaketë të zezë mbi një bluzë të bardhë dhe një kapele. Edhe Maroney kishte zgjedhur stilin e njëjtë të veshjes.



# Blake Lively për një javë vuri bizhuteri 6.5 milionë dollarësh

Blake Lively ka kohë që konsiderohet si një nga fytyrat publike që vishet me më së shumti stil dhe shije. Së fundmi, aktorja e njohur e vërtetoi edhe një herë këtë fakt. Gjatë një vizite në qytetin e New Yorkut, Lively vuri bizhuteri me çmim hiç më të vogël se 6.5 milionë dollarë. Bizhuteritë që aktorja mbante e që ishin me bollëk ishin të markës Lorraine Schwartz.

# Kourtney Kardashian është më mirë pa të dashurin



Kourtney Kardashian është shumë më mirë pa ish të dashurin e saj, Younes Bendjima. Kështu të paktën ka thënë një burim i afërt me yllin e reality shout për revistën "Us Weekly". "Ajo po mësohet me jetën si beqare. Ndarja me Younes pritej që një kohë të gjatë. Ajo është shumë mirë. Kourtney është më mirë pa të", ka thënë ky burim. "Us Weekly" ka konfirmuar më herët gjatë këtij muaji se 39-vjeçarja Kardashian është ndarë me 25-vjeçarin Bendjima pas gati dy vjetësh lidhje dashurie.




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | SALZBURG - RED STAR | 1 | MILLWALL - PLYMOUTH | 1 | KAIZER CHIEFS - BLOEMFONTEIN | 1 |
|---|---|---|---|---|---|---|

# Thaqi: Flamurtari do të jetë befasia e kampionatit

**Strategu Arsim Thaqi është optimist se Flamurtari i Prishtinës do të jetë befasia e kampionatit 2018/2019 në IPKO Superligë. "Nuk kemi ambicie të mëdha në klub, por synimi ynë është mesi i tabelës dhe mosrrezikimi nga rënia prej elitës. Mirëpo, nëse vazhdojmë të punojmë dhe të luajmë sikurse deri tash, sigurisht se do të jemi klubi që do ta shkaktojë befasinë më të madhe", ka thënë Arsim Thaqi, trajner i Flamurtarit**

EPOKA E RE Veton ZYMBERI



PRISHTINË, 28 GUSHT - KF Flamurtari është skuadra që ka befasuar në dy xhirot e para në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, pasi ka regjistruar dy fitore dhe është lider i klasifikimit me gjashtë pikë. Trajneri Arsim Thaqi, i cili e mori drejtimin e kësaj skuadre para fillimit të kampionatit, ka thënë se skuadra kuqezi nga kryeqyteti do të jetë befasi e kampionatit 2018/2019. "Nuk kemi ambicie të mëdha në klub, por synimi ynë është mesi i tabelës dhe mosrrezikimi nga rënia prej elitës. Mirëpo, nëse vazhdojmë të punojmë dhe të luajmë sikurse deri tash, atëherë sigurisht se do të jemi klubi që do ta shkaktojë befasinë me të madhe. Ne do të shkojmë ndeshje pas ndeshje dhe nëse e mbyllim sezonin vjeshtor në pjesën e epërme, atëherë në janar do të bëjmë transferime dhe do ta kërkojmë maksimumin, por tash është herët dhe na duhet vetëm të punojmë", ka thënë Thaqi për "Epokën e re".

Skuadra e Flamurtarit në ndeshjen e parë e mposhti Ferizajn, kurse në ndeshjen e dytë befasoi kampionen aktuale, Dritën (1-3). Trajneri Thaqi është treguar realist kur ka folur për fillim e këtij edicioni, duke thënë se nuk e ka pritur një fitore në Gjilan për faktin se Drita ka një skuadër me futbollistë cilësorë. "Të them të drejtën, nuk e kam pritur një fillim të tillë, pasi në ndeshjen e dytë përballë e kishim kampionen. Lojtarët u angazhuan shumë në pjesën e dytë dhe e panë se mund të mposhtet Drita dhe e arritëm një gjë të tillë me plot meritë", ka shtuar Thaqi, i cili një fillim të mirë kishte edhe në kohën kur e drejtonte skuadrën e Prishtinës dhe Trepçës '89. Skuadra nga kryeqyteti, që mezi e siguroi mbijetesën në edicion e kaluar, ndeshjen e tretë e zhvillon të shtunën si vendëse ndaj KEK-ut. Lidhur me këtë ndeshje Thaqi ka deklaruar se Flamurtari synon fitoren edhe përkundër faktit se kundërshtari është një skuadër e papërshtatshme. "Nuk ka kundërshtar të lehtë. I tillë është edhe KEK-u. Kjo u vërtetua edhe në ndeshjen e kaluar ku Gjilani mezi arriti t'i arkëtojë pikët e plota. Ne qëndrojmë me këmbë në tokë, edhe pse kemi arritur dy fitore dhe në ndeshjen ndaj KEK-ut do t'i qasemi me seriozitet të madh për të arritur fitore, pasi kjo dhe ndeshja tjetër me Lirinë janë shumë të rëndësishme për klubin tonë", ka deklaruar Thaqi.

# Panucci: Grezda bën 'spektakël' në fushë

LONDËR, 28 GUSHT - Eros Grezda ka arritur marrëveshje për të kaluar në skuadrën e Rangersit. Trajneri i Kombëtares së Shqipërisë, Christian Panucci, në një prononcim për mediumin britanik "The Sun" ka thënë se Grezda është një lojtar i mirë dhe se është përmirësuar shumë që nga transferimi në Osijek. "Erosi është lojtar shumë i rëndësishëm për ekipin tonë. Ai është shumë i shpejtë dhe mund të bëjë gjëra të mëdha në fushë. Mendoj se është përmirësuar shumë që nga koha



kur u transferua në Kroaci te Osijeku", ka thënë Panucci. "Nga sa informacione kam për të, më herët ka pasur interesime edhe nga klube në Itali e Turqi. Erosi është një lojtar me një nivel teknik shumë të mirë, por ai mund të shënojë edhe gola shumë të rëndësishëm, siç ai që i shënoi Turqisë për ne. Për më tepër është akoma i ri dhe mund të bëjë edhe më mirë. Ai është një lojtar kyç për ne, por edhe shumë i dashur", ka deklaruar Panucci.

## SHKURT

### Bora në vend të Pejës në Superligë

KB Borea do të zëvendësojë KB Pejën në Superligën e Kosovës në basketboll. Ky është vendimi që ka marrë Bordi Ekzekutiv i Federatës së Basketbollit të Kosovës. Pas përjashtimit të Pejës, FBK-ja hapi konkurs për vendin e lirë në Superligë, ndërsa Borea aplikoi dhe i plotësoi kushtet e kërkuara. "Miratohet aplikacioni i KB Borea Pejë në konkursin e WildCard për plotësimin e vendit të zbrazët në Superligën e Kosovës në basketboll për edicionin 2018/19 dhe KB Borea bëhet anëtari i tetë i Superligës. KB Borea do të jetë bartëse e të gjitha të drejtave të ekipeve të Superligës së Kosovës, si dhe e obligimeve të licencimit dhe regjistrimit për edicionin vijues", thuhet në njoftimin e Bordit të FBK-së.

### Hashani, trajner i Dardanës

Ish-reprezentuesi i Kosovës në futboll, Erdin Hashani, e ka nisur detyrën e trajnerit. Ai është pensionuar nga futbolli aktiv në fund të edicionit të kaluar, kurse tash ka marrë drejtimin e skuadrës së Dardanës, e cila synim ka hyrjen në Ligën e Parë. Hashani në karrierën e futbollit ka qenë i suksesshëm, pasi ka luajtur edhe në Shqipëri.

### Vardy dhe Cahill tërhiqen nga kombëtarja

Jamie Vardy dhe Gary Cahill e kanë informuar trajnerin e Anglisë, Gareth Southgate, se nuk do të luajnë më për kombëtaren, pasi dëshirojnë të përqendrohen në klubet aktuale. Sulmuesi Vardy dhe mbrojtësi Cahill nga viti 2016 ishin rregullisht pjesë e Anglisë, përfshirë edhe Botërorin e fundit "Rusi 2018".

### Irvingi dhe Haywardi rikthehen nga lëndimet

Kyrie Irving dhe Gordon Hayward janë rikthyer nga lëndimet dhe janë gati për edicionin ri në NBA. Të dy këta basketbollistë u dëmtuan në fundin e sezonit të rregullt dhe mungesa e tyre ndikoi shumë te skuadra e Celticsit, që ishte pretendente për titull në Konferencën e Lindjes. Madje Bostoni ishte në krye të renditjes për një kohë të gjatë, por mungesa e lojtarëve më të mirë në fund ndikoi te rezultatet në fushë.

## Goli i Ronaldos më i miri i sezonit



TORINO, 28 GUSHT - Nuk mund të kishte dyshime. Goli me roveshatë i Cristiano Ronaldës në sfidën ndaj Juventusit, e vlefshme për çerekfinalet e Ligës së Kampionëve, është shpallur më i bukuri i sezonit nga UEFA. Një perlë e vërtetë që nuk mund të kishte rivalitet. Në votimin në faqen zyrtare të UEFA-s goli i Ronaldos mori 197 mijë e 496 vota, nga 34 mijë e 915 vota që ishin në total. Në vend të dytë u rendit goli i futbollistit të Marseillet, Dimitri Payet (35 558) në sfidën përballë Leipzingut, ndërsa vendin e tretë e mori një femër. Bëhet fjalë për Eva Bavarro (23315), që shënoi një supergol në finalet e Evropianit U 17 për femra ndaj Gjermanisë. Kujtojmë se vitin e kaluar çmimin e golit më të bukur të sezonit e fitoi Mario Mandzukiq, ndërkohë që këtë vit është pasuar nga një tjetër futbollist bardhezi.

# Ronaldo blen Valladolidin në La Liga



MADRID, 28 GUSHT - Luis Nazario Da Lima, i njohur si Ronaldo, arriti t'i fitojë zemrat e tifozëve në aventurën e tij në kampionatin spanjoll të futbollit, por tani, vite larg nga paraqitjet mbresëlënëse në kryeqytetin iberik, vendos të rikthehet në një Real tjetër. Fenomeni ka vendosur të investojë një pjesë të mirë të pasurisë te skuadra e Real Valladolidit, klub që militon në La Liga dhe nga muaji shtator do ta ketë brazilianin pronar dhe president të ri.
Ish-sulmuesi i Interit, Milanit dhe Realit të Madridit, po finalizon blerjen përfundimtare të aksioneve, në një operacion financiar që do të shkojë deri në 30 milionë euro. Pas kompletimit të procedurave dhe miratimit nga organet fiskale spanjolle, Ronaldo do ta marrë postin e presidentit, ndërsa kreu aktual i klubit të Valladolid, Carlos Suarez, do të mbetet administrator i deleguar.
Fenomeni po mbyll kështu një tratativë të gjatë, të nisur në muajt e parë të vitit 2018. Blerja e skuadrës nga La Liga dukej diçka e largët, pas futjes në tratativa të meksikanit Ernesto Tinajero, që kishte ofruar më shumë. Por, Ronaldo ngadhënjeu mbi palët duke marrë edhe aksionet e Valladolidit.

# Bolti përgatitet për debutim në Australi



CANBERRA, 28 GUSHT - Pas një jave përgatitje në Australi me skuadrën e Central Coast Mariners, rekordmeni i botës në garën e 100 dhe 200 metrave, Usain Bolt, pritet të debutojë ditën e premte në një ndeshje miqësore që ekipi i tij do të luajë ndaj një ekipi amator. Fituesi i tetë medaljeve të arta olimpike është përgatitur mirë gjatë kësaj periudhe dhe pritet të luajë si mesfushor i krahut të majtë në këtë miqësore. "Jam pak nervoz dhe i tillë do të jem edhe në këtë ndeshje miqësore. Nuk është si të luaj në një takim bamirësie. Ky është një test i rëndësishëm për mua, pasi synoj të nis një karrierë si futbollist profesionist. E di që mund të bëj mjaft gabime, që nuk do të jetë ndeshja ime e përkryer, por do ta jap maksimumin për ta bërë veten time të ndihet krenar", ka thënë Bolt. Duke folur për përgatitjet që ka kryer gjatë ditëve të fundit, sprinteri xhamajkan, që gushtin e kaluar u largua nga atletika, shtoi: "Jam stërvitur si mesfushor i krahut të majtë, pozicioni që u përshtatet më së shumti karakteristikave të mia. Nuk pres që gjatë lojës të vrapoj lart e poshtë gjatë gjithë kohës. Kjo është lojë grupi dhe jemi praktikuar mirë që t'i përshtatem lojës së skuadrës".

## SHKURT

### Simona Halep eliminohet nga "US Open"

Turneu i tenisit "US Open" rezervoi një surprizë të bujshme në ditën e parë, me eliminimin e papritur të numrit një të botës në kategorinë e femrave.
Në edicionin 138 të "Grand Slam"-it amerikan "startoi" me surprizë Simona Halep, dominuesja e renditjes botërore dhe kryesorja në këtë muaj. Thuajse asnjë nuk kishte dyshime se kush do të fitonte mes Simona Halep dhe 33-vjeçares nga Estonia, Kaia Kanepi. Por, mes çudisë së publikut që kishte paguar bileta të shtrenjta, ishte sportistja "outsider" që arriti të fitojë në dy sete, me shifrat 6-2 dhe 6-4. Halep u detyrua ta braktisë "tokën e premtuar" në vetëm 1 orë e 15 minuta lojë. Kjo është hera e parë në historinë e turneve "Open", që numri një i botës eliminohet që në provën e parë. Ngushëllimi i vetëm i tenistes rumune është që do të mbetet në podiumin global, sido që të shkojë turneu amerikan. 26-vjeçarja nga Konstanca nuk e ka për herë të parë dështimin që në startin e turneut, pasi në 34 raste ka regjistruar humbje për 12 herë në turin e parë.

### Pensionohet basketbollisti Manu Ginobili

Basketbollisti i njohur Manu Ginobili ka vendosur të pensionohet nga loja e basketbollit në moshën 41-vjeçare. "Mes shumë emocionesh dhe ndjenjash po njoftoj tërheqjen time nga basketbolli. Falënderime të pafundme për të gjithë, familjen, miqtë dhe shokët e skuadrës, trajnerë dhe tifozë, të gjithë ata që janë përfshirë në karrierën time 23-vjeçare. Ishte një udhëtim përrallor", ka shkruar Ginobilit në "Twitter".

### Mourinho: Kam më shumë tituj se 19 trajnerët e Premierë Ligës

Trajneri i Manchester United, Jose Mourinho, pas ndeshjes që skuadra e tij e humbi ndaj Tottenham Hotspurit (0-3), ka thënë se meriton respekt më të madh, pasi ka fituar tituj më shumë se trajnerët e tjerë në Premierë Ligë. "Unë kam tre tituj në Angli, ndërsa 19 trajnerët e tjerë që drejtojnë këtu ndoshta kanë dy të gjithë së bashku. Kështu që meritoj pak respekt. Unë kur kam faj, e pranoj dhe ndaj Sevillës vitin e kaluar thashë se e meritoi", ka thënë Mourinho.

### PSG-ja synon transferimin e Rodriguezit

Kampioni i Francës, Paris Saint-Germain, dështoi ta transferojë mbrojtësin e Juventusit, Alex Sandro, nga Juventusi. Tash drejtuesit e ekipit francez po synojnë një tjetër lojtar nga Seria A. Bëhet fjalë për mbrojtësin e AC Milan, Ricardo Rodriguez dhe, sipas medieve në Itali, PSG-ja ka gati ofertën prej 30 milionë eurosh. Ndërsa skuadra kuqezi, duke parë se e transferoi një vit më parë nga Wolfsburgu për 16 milionë euro dhe me transferimin e Diego Laxalt, mund të vendosë për ta shitur në këtë afat kalimtar.

### Vardy dhe Cahill tërhiqen nga kombëtarja

Jamie Vardy dhe Gary Cahill e kanë informuar trajnerin e Anglisë, Gareth Southgate, se nuk do të luajnë më për kombëtaren, pasi dëshirojnë të përqendrohen në klubet aktuale. Sulmuesi Vardy dhe mbrojtësi Cahill nga viti 2016 ishin rregullisht pjesë e Anglisë, përfshirë edhe Botërorin e fundit "Rusi 2018".

Hidroregjioni Jugor

**K.R.U "Hidroregjioni Jugor" SH.A. me seli ne Prizren**

Në mbështetje të nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr. 03/L-087 , Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Hidroregjioni Jugor "Sh. A. në Prizren morri Vendim të Shpallë:

## K O N K U R S

**Për pozitën e punës:**

**Zyrtar Kryesor Financiar (ZLF) dhe i Thesarit**

**Koeficienti i pagës :10**

**Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive te punës:**

